

DRITËHIJE NË HISTORI

(Martin Camaj & Ernest Koliqi, të pazbuluar)

nga Auron TARE

© Auron Tare, 2020


*Ky material është përgatitur ekskluzivisht për [Peizazhe të Fjalës](#).
Ndalohej riprodhimi në media pa autorizim.*



Tre vite të shkuara, dy Ministrat e Kulturës, ai Kosovës dhe ajo e Shqipërisë organizuan një Konferencë për shkrimtarët Ernest Koliqi dhe Martin Camaj.

Nuk e di qëllimin e vërtetë të kësaj Konference, por nga ato që lexova, m'ua krijua përshtypja se dy Ministrat promovuan Camajn dhe Koliqin, si dy kalorës të mohuar të letrave shqiptare. Dy kalorës që mbi veten vunë gjithmonë atdheun dhe letërsinë por që fatkeqësisht Atdheu nuk i kuptoi kurrë.

E sa për lëmin e letërsisë nuk kam kompetencën e duhur për t'i gjykuar këta dy shqytarë kalorsiakë, shpresoj që me analizën e mëposhtme lexuesit të krijojnë një ide të qartë mbi “Mitet e rreme” që promovohen dhe lartësohen edhe nga Ministrat tona të Kulturës.




Martin Camaj ishte një mësues i ri në fshatin Prekal të Malësisë në vitet '46-'47. I diplomuar në shkollën e fetërve jezuitë në Shkodër, ai tërhoqi vëmendjen e shërbimit inteligjent shqiptar në një periudhë mjaft të trazuar të pasluftës. Dihet se Malësia ishte

një zonë, që po i bënte rezistencë regjimit të ri komunist dhe si pasojë shërbimi informativ shqiptar ishte mjaft aktiv në krijimin e një rrjeti bashkëpunëtorësh.


Sipas burimeve të Dosjes së tij shqiptare, Camaj dyshohej për lidhje me një “bandë të arratisurish projugosllavë”. Për këtë arsye arrestohet në mënyrë të fshehtë më 5.5.1948 dhe sillet në Shkodër. Në 10.5.1948, merret në pyetje në zyrën e Sigurimit të Shtetit nga Kapiteni II Fadil Kapisyzi.

Dosja e deklasifikuar e Camajt ka ndër dokumente të tjera edhe një deklaratë prej disa faqesh mbi përfshirjen e tij në ndihmesën për të arratisurit antikomunistë, por në rrëfimin e tij për oficerët e Sigurimit të bie në sy se Camaj ka dëshmuar gjithashtu kundër disa prej mësuesve të tij fretër jezuitë, në veçanti Pader Fausti, Pader Dajani, Pader Roza. Duhet thënë se Pader Xhovani Fausti dhe Pader Danjel Dajani ishin dënuar ndërkohë me pushkatim në gjyqin e famshëm të Shkodrës kundër klerit katolik.



Dosja M Camaj

Megjithëse Camaj tregoi mbi përfshirjen e tij në një rrjet të arratisurish që kishin lidhje me Jugosllavinë, ai doli nga zyrat e Sigurimit të Shkodrës më 10.5.1948, pasi pranoi të rekrutohej si informator, me pseudonimin “Bregu i Kuq”.



Firmosja si informator i Sigurimit për mësuesin e ri Martin Camaj, në kontekstin e kohës, nuk e fajëson kurrsesi atë, pasi rrethanat mund ta kenë detyruar të bashkëpunojë me një organizatë të frikshme si Sigurimi i Shtetit. Megjithatë, duhet pasur parasysh se Zbulimi Sekret Shqiptar, në atë kohë, kishte ndërtuar një platformë sekrete për hedhjen me mision jashtë kufijve të Shqipërisë të informatorëve të saj, pasi u përgatiste një plan mbulimi operacional. Kjo procedurë e njohur si “Illegalët”, të cilët në kontekstin e kohës ishte përdorur gjerësisht nga NKVD (KGB) sovjetike në Europën Perëndimore, ishte përshtatur edhe nga Sigurimi në operacione kundër Jugosllavisë dhe më gjerë.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERIS
SEKSIONI I FUNKSIONEVE DHE SHIKIMEVE
N/SKEMERIT I SIGURIMIT SI SHKEMERIT
SHTETI

0001524

V.P. 1.2.
SHKEMERIT NR 5-11/48

Nr. "A" 341 Res.Pers.

Lenda: Propozim për rekrutim 1) Paqar
Në sektorin: 2) 6. Hapësirë
Të quajturin: Martina Camaj

DREJTORIA SIGURIMIT SHTETI

T E X T I

I-) Propozimi për të rekrutuar në fjalën informativ me cilat më
1) Paqar të kualifikim (em, e ilagasi)
Martina Camaj i biri Shkëlzi dhe i
i dat-lindjes 1929 lindur në katundin Deshmora të
krahut të shtetit Paqar bashë me katundin Paqar
të shtetit ose shtetit Paqar bashë me katundin ose shtetin
Ni katund në profesion Udhëtar gjendja civile
shërbën në 3) Udhëtar në arsim Udhëtar i cili
Paqar i organizuar në "S.K.R.P." dhe datën 5)

II-) Qëllimi i rekrutimit Udhëtar

6) Rekrutohet në sup. eblin ose jo: Udhëtar 7) objekti
ku do të bëjë punën e sigurimit Udhëtar bashë me katundin
Paqar dhe 8) Në se propozohet resident, në informator, objekt
ose katund ka në lidhje:

9) Në se propozohet agjent kundër grupeve kundërshtarë politike, elitë e
e përhapet këto grupe:

10) Në se propozohet agjent kundër krijesave t'arshi mnyellit janë këto
krijesat: Udhëtar bashë me katundin Paqar
Paqar bashë me katundin Paqar

0 - 0

(Dosja Camaj)

Në Shtator të 1948 Martin Camaj arratiset drejt Jugosllavisë së bashku me një numër eksponentësh lokalë antikomunistë. Informacioni më i saktë mbi arratisjen e Camajt dhe grupit që ai iu bashkua, gjëndet në përshkrimin e Padër Daniel Gjecaj botuar vite më pas në Itali. Në keto kujtime mësojmë edhe emrat e personave me të cilët u arratis Martin Camaj nga Malsia.

1. Nikë Sokoli prej Bëtoshet
2. Shpend Sadiku prej Bëtoshet
3. Zef Zogu prej Bëtoshet
4. Gjon Bala prej Salcet
5. Marashi Tushi prej Salcet
6. Pali Ceka prej Salcet
7. Buh Matoshi prej Salcet
8. Mark Alia prej Salcet
9. Mirash Uka (Paschalis Mirash Uka prej Palç
10. Prellë Marku
11. me të shoqen, Zojën, prej Shalet,
12. Gjëllosh Toma

13. me të shoqen Mrinë
14. e me motër;
15. Sadik Marku
16. me motër prej Shalet;
17. Gjeto Marku
18. me të shoqen Agen, prej Shalet;
19. Vati Marashi i Shoshtit;
20. Ndrë Cufa prej Thehthit
21. Pashko Cufa prej Thehthit
22. Kolë Leka prej Thehthit
23. Marash Nika prej Thehthit
24. Lekë Martini prej Thehthit
25. Nikë Vuksani prej Shalet
26. Gjon Destanisha prej Shalet
27. Lazër Pali prej Sumet
28. Martin Camaj prej Temalit
29. Murrec Sadrija
30. me të nipin Nikë Gjonin prej Mërturit
31. Marash Kolë Hajdari prej Shalet
32. me të shoqen Lenë Delija
33. Patër Daniel Gjecaj prej Thehthit
34. Musli Çuni prej Nikajsh, i Çun Nikës
35. Gjergj Pllumi prej Thehthit
36. Cul Pllumi prej Thehthit.

Megjithëse në atë kohë nuk kishte shumë informacion mbi këtë arratisje, në dosjen e zbulimit politik Shqiptar në vitin 1959 ka një detaj interesant për daljen e Camajt drejt Jugosllavisë.

1948, bio në kontakt me bandën e spiunazhit Jugosllav të kryesuar nga i aratisur Lazer Pali, ku me vonë bashko me të u aratis për në Jugosllavi, duke ju dhënë kështu Jugosllaveve informata me karakter të ndryshëm mbi vendin tonë.

Vendoset në Tuz (Mal i Zi) si mësues. Çuditërisht në datën 21 shtator 1950, emri i tij përmendet në një dokument të shërbimit amerikan të zbulimit që mbante në vëzhgim aktivitetin inteligjent jugosllav, UDB.

CIA

Raport informativ`

datë 21 shtator 1950

Lënda: Konditat në Universitetet Jugosllave

*Pika C. Studentët e huaj janë nga Shqipëria, Bullgaria, Rumania dhe Hungaria dhe duket se janë anitkomintern. Këta studentë janë strehuar në “Studenski Dom”, Konvikti i Studentëve) me një kosto prej 1.500 dinarë në muaj. Studentët jokomunistë shqiptarë përfshijnë Danish Daci, Enver Metani, Cesk Dajci, Halil Topalli dhe **Martin Camaj**.*

Janë gjithashtu rreth 30 shqiptarë nga Kosova në universitete.

Po kështu në një tjetër raport të CIA-s, kësaj radhe mjaft të gjatë, emri i Martin Camajt konfirmohet përsëri si student, por këtë radhë i Universitetit të Beogradit.

CIA

Raport Informativ

Vendi: Shqipëria/Jugosllavia

Subjekti: Shqiptarët në Jugosllavi, aktivitete të rezistencës në Shqipëri, kampet e përqendrimit në Shqipëri

Datë e shpërndarjes: 11 gusht 1951

Vendi i marrjes së informacionit 25X1A

(Dokumenti i cili hapet me një gjysmë faqeje të fshirë, për të ruajtur informacion të klasifikuar, vazhdon me një sërë informacionesh operative të terrenit).

Pika 2: Dalish Daci, Martin Camaj dhe Skënder Copisati tre studentë shqiptarë, të cilët janë arratisur nga vendi i tyre, tashmë janë duke ndjekur Universitetin e Beogradit. Shpenzimet e tyre janë (shuma e fshirë) dhe paguhen nga Qeveria Jugosllave.

Nuk ka asnjë të dhënë nga burimet arkivore në dispozicion, nëse Camaj ka treguar për autoritetet jugosllave rekrutimin e tij nga shërbimi shqiptar. Megjithatë me të drejtë lind pyetja se përse nga rreth 25 studentë shqiptarë në Universitetet Jugosllave (dokumenti i mëposhtëm) amerikanët kanë përmendur Martin Camajn?

Dokumenti i deklasifikuar

Arkivi i CIA-s Washington D.C.

Dokumenti i CIA-s

Tetor/nëntor 1952

Tema: Takim i Emigrantëve Shqiptarë në Jugosllavi

Archive: CIA-RDP80-00809A0007001466-2

(Takimi i mbajtur në Shkup me 25-26 tetor 1952, në prani të një numri zyrtarësh jugosllavë dhe Gjeneralit të UDB-së Mugosha)

Fjalimi i Tajar Hatibit, anëtar i Komitetit drejtues të Komitetit të Prizrenit “sot janë 171 studentë refugjatë shqiptarë në shkollën elementare, 61 në shkollën e mesme, 4 në normalen e Gjakovës dhe 25 në Universitet”.

Përmendja e emrit të Martin Camajt si student në Universitetin e Beogradit me të drejtë sjell pyetjen si mundi mësuesi refugjat shqiptar nga Prekali të fitojë një bursë studimi për në Universitetin e Beogradit? Aq më tepër, përse shërbimi sekret amerikan e ka vendosur atë në vëzhgim, duke theksuar emrin e tij në dy dokumente raporti nga terreni?

Mos vallë për një arsye shumë të thellë, të cilën e shpjegon dokumenti i mëposhtëm?

Raport Informativ

Vendi: Shqipëria/Jugosllavia

Raporti: emri i fshirë

Subjekti: Refugjatët shqiptarë në Jugosllavi dhe Lega e refugjatëve Shqiptarë (Komiteti i Prizrenit).

Data e shpërndarjes: 26 shkurt 1954

Data e informacionit (fshirë)

Vendi i marrjes (fshirë)

Numri i faqeve 5

Pika 11. Studentët shqiptarë në Universitetin e Beogradit gjithashtu janë financiar dhe drejtuar prej UDB-së. Një oficer i UDB kontrollon notat e tyre pas provimeve dhe atyre që tregohen më të zellshëm u jepen shpërblime në para si dhe mundësi për të udhëtuar në Dalmaci dhe Zagreb.



Në vitin 1951 Camaj njihet dhe martohet me një studente serbe, Nina Bogdanovich, vajza e ish-nënkryetarit të Bashkisë së dikurshme të Beogradit. Duket se fati po i printe, pasi për një kohë shumë të shkurtër, nga një refugjat i arratisur ishte tashmë një student i Universitetit të Beogradit. Martesa (civile dhe jokishtare, duhet theksuar) me Ninën duket se e ka futur atë në shoqërinë e lartë beogradase. Nuk ka asnjë të dhënë, nëse takimi i dy të rinjve ishte e orkestruar nga UDB-ja. Megjithatë po t'i referohemi dokumentit të mësipërm, duket e pamundur që kjo lidhje të mos ishte kryer të paktën me miratimin e UDB-së. Një dyshim mbi këtë fakt del edhe nga vëzhgimi i mëposhtëm.

Studiuesi Arben Ndreca ka botuar një seri letrash të çiftit të ri (*Letra të panjohura dashurie, përktheu prej serbo-kroatishtes Arben Ndreca*) të shkruara në vitin 1951, kohë kur çifti pushonte në një resort malor në Zlatibor.

Duhet theksuar se Camaj ishte një student pa asnjë të ardhur përveç bursës studentore dhe pushimet jashtë Beogradit kanë pasur vështirësitë e tyre. Zlatibori ende sot konsiderohet si një pikë pushimi mjaft e preferuar për turizmin malor të skive dhe pushimet klimaterike, të cilat konsiderohen si turizëm elitare. Me te drejtë lind pyetja: me çfarë të ardhurash pushonte në këtë resort malor ky i ri refugjat? A mos vallë këto pushime ishin shpërblimi për të cilin flet dokumenti i mësipërm i CIA-s për studentët shqiptarë?

Gjatë viteve 1950-1956, Camaj qëndroi në Beograd, ku studioi në Fakultetin e Shkencave Gjuhësore. Biografët e tij e kanë cilësuar këtë periudhë si një periudhë kur studiuesi i ri ishte tërësisht i përkushtuar ndaj çështjes letrare jashtë çdo angazhimi tjetër.

Por dokumenti i mëposhtëm sjell një të dhënë tërësisht të panjohur, duke konfirmuar se Martin Camaj në fakt ka qenë i angazhuar edhe në një aktivitet të rëndësishëm politik: **Komiteti i Prizrenit**.

Document Number (FOIA) /ESDN (CREST):

CIA-RDP80-00810A005600130002-7

Release Decision: RIPPUB

Original Classification: S

Document Page Count: 4

Document Creation Date:

Content Type:

REPORT

Pika 22; Lutfi Spahiu nuk është më anëtar i ekzekutivit. Kushëriri i tij Ramadan Spahiu është një anëtar. Martin Camaj një anëtar i ri punon në Radio “Beograd”.

Ky pasazh nga dokumenti prej 4 faqesh i CIA-s amerikane na sjell dy të dhëna shumë të rëndësishme mbi aktivitetin e Martin Camajt në periudhën e qëndrimit në Beograd: anëtarësimin e tij në “Komitetin e Prizrenit” (në ekzekutiv) dhe faktin se tashmë ai ishte një punonjës i Radio “Beogradit”. Analiza mbi këto dy-tri të dhëna ngre disa pikëpyetje të cilave do të mundohemi t’iu përgjigjemi nga dokumentacioni amerikan në vijim.

Document Number (FOIA) /ESDN (CREST):

CIA-RDP80-00810A006100290013-2

Original Classification: S

Document Page Count: 5

Publication Date: March 11, 1955

Content Type: REPORT

COUNTRY Albania SUBJECT Radio Propaganda Beamed

RD DATE DISTR. i Radio Belgrade 1. Prior to normalization of relations between **Albania ...** and Yugoslavia, **Radio Belgrade** had the most effective **anti-Albanian** propaganda broadcasts...

Radio Beogradi 1. *Përpara normalizimit të marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi, Radio Beogradi kishte transmetimin propagandistik me efikas antishqiptar. Në të njëjtën kohë Radio Tirana i kushtonte përpjekjet me të mëdha propagandës kundër Jugosllavisë ...*

Ky pasazh i dokumentit të mësipërm tregon qartë se çfarë ishte Radio “Beogradi” dhe për çfarë përdorej në atë periudhë. Ndërkohë lind pyetja se si Martin Camaj, një emigrant politik shqiptar, pa njohje dhe pa kontakte, papritur të punësohet në qendrën me të rëndësishme të propagandës jugosllave? Camaj për më shumë nuk ishte as gazetar. Deri më sot askush nuk i është përgjigjur kësaj enigme.

KOMITETI I PRIZRENIT

Rreth aktivitetit të Komitetit të Prizrenit ka një sërë dokumentesh në arkivin e deklasifikuar amerikan. Do të ishte me shumë interes që këto dokumente të krahasoheshin edhe me dokumentet italiane, britanike dhe ruse, për të kuptuar në të gjitha dimensionet e saj rolin që kishte kjo organizatë politike shqiptare e kohës. Duke pasur parasysh se dokumentacioni jugosllav nuk është i hapur për studiuesit, jemi të detyruar ta shikojmë këtë Organizatë në këndvështrimin e shërbimeve inteligjente amerikane për të kuptuar rolin e vërtetë të saj.

ALBANIAN REFUGEE ORGANIZATION IN YUGOSLAVIA

Document Number (FOIA) /ESDN (CREST):

CIA-RDP80-00810A001300760008-6

Release Decision: RIPPUB

Original Classification: S

Document Page Count: 3

Document Creation Date: May 29, 1953

Content Type: REPORT

2. Në maj të 1951-shit me nxitjen e Jugosllavisë, Komiteti Shqiptar i Prizrenit u krijua nga refugjatët shqiptarë, me qëllime të cilat mund të përmbliidhen si më poshtë:

a. Vazhdimi i përpjekjeve për të tërhequr refugjatët shqiptarë në Jugosllavi me krijimin e një organizate “dinamike” dhe si rrjedhim krijimin e kushteve jetësore më të mira për refugjatët.

b. Organizimin dhe trajnimin e një force të armatosur ndër refugjatët, e cila në kohë do të përdoret për çlirimin e Shqipërisë.

c. Organizimin e një rrjeti të inteligjencës në Shqipëri për qëllimet e

Jugosllavisë si dhe për lehtësimin e depërtimit të Titizmit mes qarqeve të partisë komuniste Shqiptare me qëllimin final rrëzimin e pushtetit aktual.

*3. Komiteti Shqiptar i Prizrenit drejtohet nga një presidium, i cili është i kompozuar nga 21 persona, të cilët kanë pëlqimin e plotë të Titos. **Komiteti i Prizrenit ka personelin e nevojshëm të formojë grupe “ndërlidhëse”, të cilat operojnë për Qendrën e Avancuar të inteligjencës së UDB-së, përgjatë kufirit jugosllav me Shqipërinë.** Për informacion këto Qendra të Avancuara Inteligjente janë lokalizuar në qytetet e mëposhtme: Prizren, Titograd, Gusinje, Struga, Ohër, Ulqin, Pejë, Dibër.*

Dokumenti i mësipërm amerikan bën të qartë se Komiteti i Prizrenit ishte një organizatë thellësisht politike, e cila përpos organizimit të një force të armatosur gati për t’u përdorur në një moment oportun, ishte pikë së pari një organizatë përmes së cilës UDB-ja kishte ndërtuar një rrjet informativ për të depërtuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe në diasporën shqiptare. Pra e thënë me thjeshtë, një organizatë spiunazhi.

Ndërkohë, me shumë interes është fakti se në këtë organizatë politike dhe spiunazhi dallohen disa emra të cilët ishin pjesë e grupit me të cilët u arratis Martin Camaj. Në veçanti lideri i grupit NIK SOKOLI prej Betoshet i cili duket se ka një pozicion shumë të rëndësishëm në këtë organizatë si dhe Pader Daniel Gjecaj (Mark Gjecaj) i njohur me nofkën Miku i Maleve.

8. Nik Sokoli, retains his post as Committee Vice-President. Qazim Lushi, Can Tahiri, Mark Ujka, and Kol Hasa, are faithful tools of their UDB masters.

8. (Emrat e fshirë) Nik Sokoli e mbajti postin e tij si zëv President i Komitetit, Qazim Lushi, Can Tahiri, Mark Ujka dhe Kol Hasa janë vegla besnike te padronëve të UDBs.
(Document Number CIA-RDP80-00810A003600930003-7)

is without importance. The Consultative Committee also includes Ndue Pjeter Gjonmarkaj and Mark Gjecaj ("l'Amico delle Montagne"2). The latter has been assigned duties as an inspector in order, it is said, to compromise him. Gjecaj himself was most unhappy with this appointment but his every attempt to avoid it was in vain.

Komiteti Konsultativ gjithashtu përfshin Ndue Pjeter Gjonmarkaj dhe Mark Gjecaj (Miku i Maleve). Këtij të fundit i është caktuar detyra si inspektor, siç thuhet, për ta kompromentuar. Gjecaj vetë ishte shumë i pakënaqur nga kjo detyrë por përpjekjet për t'iu shmangur ishin të kota.

Në diasporën shqiptare vepronin në atë kohë tri organizata kryesore antikomuniste, të cilat kishin mision rrëzimin e qeverisë Hoxha.

- Komiteti “Shqipëria e Lirë”, themeluar nga shërbimi inteligjent anglo-amerikan;
- Blloku Independent Kombëtar, i themeluar nga zbulimi inteligjent italian;
- Komiteti i Prizrenit, i themeluar nga UDB-ja.

Të trija këto organizata punonin në mënyrë të pavarur kundër qeverisë Hoxha, duke mbështetur kryesisht politikën e sponsorizuesve të tyre. Të trija organizatat kishin marrë rolin e një qeverie në emigracion, por përtej fasadës politike dhe propagandës antikomuniste, këto organizata luanin rolin kryesor në rekrutimin e agjenturës dhe dërgimin e misioneve zbuluese në Shqipëri.

Komiteti “Shqipëria e Lirë” me kampin e fshehtë në Mynih dhe Maltë, të sponsorizuara nga CIA/MI6, nëpërmjet Operacionit të koduar *BGFIEND/Valuable*, dërgonte grupe paraushtarake nga ajri, toka dhe deti, kryesisht në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut.

Blloku Kombëtar Independent (BKI) ishte një front për zbulimin inteligjent italian (inteligjenca navale), që dërgonte njerëz kryesisht në Shqipërinë e Veriut dhe në Elbasan.

UDB-ja, e cila nëpërmjet Komitetit të Prizrenit dërgonte grupe paraushtarake në Shqipërinë e Veriut dhe në fiset e Malësisë, të cilat tradicionalisht kishin pasur kontakte me jugosllavët në periudha të ndryshme historike.

Duhet thënë se për vetë lidhjet e ngushta që kishte pasur Jugosllavia me Shqipërinë e pasluftës, shërbimi inteligjent jugosllav kishte njohuri të sakta dhe lidhje shumë të rëndësishme në hierarkinë komuniste shqiptare.

Për të gjitha këto arsye, si dhe për faktin që Komiteti i Prizrenit ishte një organizatë parësore kundër regjimit të Hoxhës, sigurisht që ai duhej të ishte në vëmendjen kryesore të organeve të Sigurimit të Shtetit. Ka një sërë dokumentesh që provojnë se Sigurimi shqiptar përpjeqej të depërtonte në këtë organizatë, për të qenë në dijeni të planeve të UDB-së, duke pasur parasysh kontekstin në të cilin zhvilloheshin ngjarjet politike në atë periudhë dhe aktivitetin e Organizatës “Komiteti i Prizrenit”.

Me të drejtë lind pyetja, përse Martin Camaj kishte vendosur të anëtarësohej në këtë organizatë politike projugosllave? Mos ishte ky një mision infiltrimi për “Brezin e Kuq”? Apo Shërbimi Inteligent Jugosllav interesohej për studiuesin Camaj si një zbulues me të ardhme? Zhvillimi i ngjarjeve do t’u japë përgjigje këtyre pyetjeve intriguese.

Le të shohim një tjetër fragment nga një Raport i CIA-s mbi Komitetin e Prizrenit.

Raport Informativ

Vendi: Shqipëria/Jugosllavia

Raporti: emri i fshirë

Data e shpërndarjes: 26 shkurt 1954

Data e informacionit (fshirë)

Vendi i marrjes (fshirë)

Numri i faqeve 5

Pika 5. Përveç atyre refugjatëve që janë vënë në shërbim të UDB-së dhe operojnë kundër bashkëkombësve të tyre, asnjë shqiptar në Jugosllavi nuk ka besim në programin e Komitetit të Prizrenit. Kjo organizatë konsiderohet si një fasadë, përmes së cilës Jugosllavia po përgatit aneksimin e Shqipërisë.

Një fakt tjetër mjaft domethënës mbi aktivitetin e “Komitetit të Prizrenit” si qendër e spiunazhit jugosllav, është prania e gjeneralit Dushan Mugosha si kryetar në hije i kësaj organizate.

Dushan Mugosha, malazes që fliste rrjedhshëm shqip, për kohën konsiderohej si një prej ekspertëve më të mirë jugosllavë për çështjet shqiptare. Gjenerali Mugosha citohet në një sërë dokumentesh të CIA-s si personi përgjegjës jo vetëm për drejtimin e Komitetit, por edhe për rrjetin e spiunazhit kundër Shqipërisë.

Document Number (FOIA) /ESDN (CREST):

CIA-RDP80-00810A005600130002-7

Release Decision: RIPPUB

Original Classification: S

Document Page Count: 4

Document Creation Date: January 3, 1955

Content Type: REPORT

* .. General Dushan **Mugosha** in the UDB, are among the chief recruiters of Albanian agents who are sent into Albania.

Document Number (FOIA) /ESDN (CREST):

CIA-RDP80-00810A001300760008-6

Release Decision: RIPPUB

Original Classification: S

Document Page Count: 3

Sequence Number: 8

Date: May 29, 1953

Content Type: RAPORT

REPORT: ALBANIAN REFUGEE ORGANIZATION IN YUGOSLAVIA

* The head of the Albanian activities in Yugoslavia is General **Dushan Mugosha**

Document Number (FOIA) /ESDN (CREST):

CIA-RDP80-00810A005500290005-8

Release Decision: RIPPUB

Original Classification: S

REPORT

Albanian Refugees (Prizren Committee) held on 20 October 1954, **Dushan Mugosha** announced the propaganda towards Albania will be discontinued.....

Të gjitha këto të dhëna e vendosin figurën e Martin Camajt në një këndvështrim tjetër, duke hedhur dritë përtej rolit të tij si letrar dhe poet duke ngritur një sërë pikëpyetjesh për aktivitetin në hije gjatë periudhës së qëndrimit në Beograd.

Siç theksuam me sipër, Camaj qëndroi për gati 6 vjet në kryeqytetin jugosllav, ku përveç studimeve në Universitet, ka punuar në Radio “Beogradi”, ka qenë pedagog në Universitetin e Beogradit, si dhe është aktivizuar në organizatën politiko/inteligjente “Komiteti i Prizrenit”. Por papritmas, Martin Camaj vendos të largohet nga Beogradi.

Biografët e tij deri më sot nuk kanë dhënë asnjë sqarim, se si Camaj mundi të largohej nga Jugosllavia. Largimi i tij drejt Italisë në fakt ka disa dritëhije që sjellin një sërë pikëpyetjesh. Si mundi Martin Camaj të merrte lehtësisht miratimin e autoriteteve jugosllave për t’u larguar nga Beogradi? A ka aplikuar Camaj si shumë refugjatë të tjerë pranë organizatave të refugjatëve për emigrim? Shumë shqiptarë emigrantë politikë në Jugosllavi aplikonin për emigracion në Amerikë, Australi apo vende të tjera të Europës Perëndimore. Ndërkohë Camaj papritur gjendet në Romë.

Të gjitha këto pyetje mund të marrin edhe një përgjigje normale, duke theksuar se largimi drejt Romës mund të ketë qenë thjesht një dëshirë e vetë Camajt. Por nëse japim përsëri kontekstin e kohës mund të themi se koha e largimit të Camajt nga Beogradi përkon me momentin kur aktiviteti politik jugosllav antishqiptar pëson ndryshim të kursit.

Është koha kur Nikita Hrushovi kishte kërkuar që udhëheqja shqiptare të mos ndërmerre propagandë agresive ndaj Jugosllavisë si pjesë e një pakti pajtues që Sovjetikët kërkonin të impononin mbi Enver Hoxhën.

Një afrim i mundshëm Beograd -Tiranë ishte një prej kërkesave sovjetike dhe Beogradi i ishte përgjigjur pozitivisht kërkesës së Hrushovit pas vizitës së këtij të fundit për të takuar Titon. Ky ndryshim kursi i politikës jugosllave, e konfirmuar nga disa dokumente të CIA-s, të cilat raportonin se papritur Radio “Beogradi” kishte ulur tonin e propagandës antishqiptare, Komitetit të Prizrenit i kishin ardhur orientime të reja, se për momentin nuk kishte asnjë plan për mësymje drejt Shqipërisë. Një sërë shqiptarësh të emigracionit politik kishin filluar të shikonin mundësinë e largimit drejt Turqisë apo Amerikës.

Ndërkohë Martin Camaj nuk dukej se prekej nga këto zhvillime të reja. Puna në Universitetin e Beogradit dhe në Radio “Beogradi” i siguronte të ardhura të mira. Martesa me një vajzë të një familje të njohur beogradase e ndihmonte gjithsesi për të pasur një status konfort. E megjithatë Camaj vendos të rifillojë edhe një herë jetën prej refugjati në një kamp italian. Lind pyetja përse?

A mos vallë “Brezi i Kuq” dërgohej me mision të ri? Apo shërbimet jugosllave kërkonin të depërtonin diasporën politike shqiptare në Itali? UDB-ja kishte tentuar disa herë që me anë të shqiptarëve të rekrutuar të depërtonte atje apo të siguronte informacion mbi planet e BKI-së. Dërgimi i një poeti që sapo kishte filluar të njihej nga qarqet intelektuale shqiptare mund të ishte një operacion i mundshëm.

INTELEX FAX 20	CLASSIFICATION SECRET/CONFIDENTIAL U.S. PROTECTIVE SERVICE	SECURITY INFORMATION	REPORT NO.
	CENTRAL INTELLIGENCE AGENCY		CD NO. 25X1A
INFORMATION REPORT			
COUNTRY	Albania/Yugoslavia/Italy	DATE DISTR.	20 Nov 51
SUBJECT	UDB Plan for Contacting Albanian Emigre Leaders in Italy	NO. OF PAGES	1
PLACE ACQUIRED	25X1A	NO. OF ENCLS. (LISTED BELOW)	
DATE OF INFO.	Mid-November 1951	SUPPLEMENT TO REPORT NO.	

DO NOT CIRCULATE

K1X

1. In the near future the UDB intends to send Bardhok Mark Doda, Pjeter Doda, and another unidentified Albanian from Yugoslavia to Rome, where they will contact all Albanian leaders in that city in an attempt to discover their attitude towards Yugoslavia.
2. Qasim Gojani, currently employed by the UDB, will send Din Zhabi (sic - probably Zhabi) from Yugoslavia to Rome sometime in December 1951 with

“në të ardhmen UDB-ja kërkon të dërgojë Bardhok Mark Doda, Pjeter Doda si dhe një tjetër shqiptar nga Jugosllavia të pa identifikuar, në Romë ku ata do të kontaktojnë të gjithë udhëheqësit shqiptarë në atë qytet me synim të zbulojnë qëndrimin e tyre karshi Jugosllavisë”


Të gjitha këto pikëpyetje duhen ngritur në kontekstin e kohës. UDB-ja në atë periudhë kishte dërguar në Itali një prej ekspertëve të saj më të mirë për Shqipërinë, Kolonelin Cedo Mijovich. Koloneli kishte pasur një sërë takimesh me eksponentë të Bllokut Kombëtar Independent për të folur për çështjet shqiptare. Mijovich u kishte përcjellë emigrantëve politikë të kësaj organizate qëndrimin e ri politik të Titos, i cili respektonte kufijtë e Shqipërisë, uljen e tensionit me Tiranën, si dhe rikonfirmimin për autoritetet greke se Jugosllavia nuk kishte asnjë pretendim territorial ndaj Shqipërisë. Me një interes shumë të madh, mund të themi, lexojmë në dokumentin e mëposhtëm deklaratën e Kolonelit, i cili thekson propozimin që Tito kishte marrë nga Randolph Churchill, djali i kryeministrit Britanik, i njohur i vjetër i Titos. Ky propozim ishte për një ndarje të Shqipërisë midis Jugosllavisë dhe Greqisë. Propozim i cili kishte hasur në kundërshtimin e Titos.

STATEMENTS BY CEDO MIJOVIC TO BKI LEADERS IN ROME

(Document Number (FOIA) /ESDN (CREST): CIA-RDP82-00457R014000240010-3)

A ishte ky takim një matje pulsi e shërbimeve italiane, që monitoronin zhvillimet politike në Shqipëri? A kërkonin jugosllavët një bashkëpunim me diasporën shqiptare në Itali për një Front më të gjerë anti-Hoxha? A ishte propozimi i Churchill-it i vërtetë apo një bluf jugosllav? Në mungesë të dokumentacionit të palës jugosllave vetëm mund të spekulojmë. Megjithatë, mund të themi me siguri se UDB-ja ka pasur në fokusin e saj depërtimin e komiteteve paralele, si Bllokut të mbështetur nga italianët dhe Komitetit “Shqipëria e Lirë” nga anglo-amerikanët. Në një sërë dokumentesh të CIA-s kjo përpjekje është mjaft e qartë.

Megjithatë për largimin e Camajt nga puna e rehatshme në Radio “Beograd” drejt kampeve të refugjatëve në Itali kemi një dëshmi autentike nga vetë ai: një letër e dërguar nga Martin Camaj dy miqve të tij në Romë, ku u kërkon ndihmë për t’u larguar nga Beogradi. Megjithëse letra e ruajtur në arkivin e CIA-s është dërguar nga Camaj, analiza jonë është se kjo letër duhet marrë me shumë rezerva, pasi ka mundësi që arsyet e vërteta të mos jenë treguar në këtë letër. Përse?



1.

“Më poshtë përkthimin e një letre që i është dërguar (emri i fshirë), si dhe Lazer SHELDIJA-n nga Martin Camaj prej Beogradit, Jugosllavi. Zarfi i letrës ka vulën postare Vilach, Austria, 16 janar 1956. Sipas (emri i fshirë) ishin shërbimet amerikane në Beograd ato që mundësuan nxjerrjen e letrës në Austri, prej ku u dërgua me postë normale në adresën e Lazer SHELDIJA, Via (nuk lexohet qartë) VII, 16, ROMA. SHELDIJA është një nxënës seminarist mik i CAMAJT, aktualisht në Romë, por që ka jetuar dy vjet në Beograd.

2.

I dashur (emri i fshirë) dhe Lazer, duke qenë se kam qenë shumë i mërzhitur, sot kam menduar për ty. Mendova se mund të punoja këtu për disa kohë, duke iu dedikuar literaturës shqiptare, shkollave shqiptare, institucioneve të ndryshme apo Universitetit, por fatkeqësisht nuk munda të kem sukses. Siç mund ta dini, unë nuk jam “politikan”. Deri më tash nuk kam kryer asnjë faj që të më komprometojë në sytë e këtij vendi (Jugosllavisë shën. ynë).

Megjithatë statusi im këtu është shumë kritik, dhe nuk e di se si punët shkuan deri këtu. Jam kritikuar nga shumë eksponentë të .. (komente nga (emri i fshirë) këtu ai nënkupton Kosovën).

Shkrimet e mia nuk pranohen më nga shtëpitë botuese, të cilave iu kam paraqitur dy libra, të cilët ishin pjesë e programit tim të 1956. “Zani i Rinisë” është i vetmi publikim, i cili në këto 5 muaj më ka botuar një poemë, që u shtyp plot me gabime dhe nuk më shërben kurrëgjë.

Një person i rëndësishëm ka dhënë urdhër të mos botohen shkrimet e mia dhe të më ndalohet puna në Universitetin e Beogradit, të cilën e fitova me zotësinë time. Jam në një situatë të rëndë ekonomike. U interesova për të mësuar për të gjitha këto dhe njerëzit thonë se Camaj dëmton rininë me punën e tij nacionaliste dhe irredentiste. Unë kam pasur mbrojtës ekselentë, por kur ata panë se çfarë po ndodhte më thanë: Tani je vetëm. Kam frikë se do të më kthejnë në Shqipëri, ashtu siç bënë me Selman Rizën dhe intelektualë të tjerë. Prandaj nëse mendon sado pak për mua, mundohu të më nxjerrësh jashtë këtij vendi. Do të doja të shkoja në Austri, ku kam jetuar më të mira. Sigurisht Prof. Krist Maloki, i cili më përkrah, mund të më gjejë një

garanci për të më nxjerrë matanë kufirit, megjithëse këto kohë ndihem shumë i zhgënjyer dhe nuk kam më besim te miqësitë.

Do të doja të kaloja (rrija) ca kohë në Austri, pasi kam filluar të mësoj gjermanisht dhe do të vazhdoj ta bëj, pasi mund të më japin një vizë më kollaj. Natyrisht e dua Ninën (koment: bashkëshortja e Camajt) me mua dhe do të doja ta formalizoja këtë gjë me Petl-in, deri sa ajo është dakord (koment: Petl është At Petlich, prifti i kishës katolike në Beograd. Camaj akoma nuk është martuar në kishën katolike). Do ta bëj këtë përpara se të largohem. Ndoshta ajo (gruaja e Camajt) do të gjente punë me kollaj se unë, pasi është eksperte e sllavistikës me profesion. Unë do ta lë vendin pa dëshirë, por nëse nuk largohem do të përfundoj keq.

Unë jam vetëm viktimë e një lëvizjeje që po zhvillohet kohët e fundit. Instituti i Albanologjisë në Prishtinë, Kosovë është likuiduar. Ndoshta jam i gabuar dhe kështu shpresoj, por kjo është përshtypja ime. Të lutem shumë mbaje për vete këtë vendim timin.. Do përpiqem të jem shumë i mirë me këta njerëz, megjithëse kam eksperiencë të keqe me ta. Një person tjetër, i cili ka qenë në Shqipëri (koment: sipas (emri i fshirë) nënkuptohet Dushan Mugosha) më ka quajtur bandit, jezuit etj. Nëse më ndodh diçka mua, që ka shumë mundësi, le të dihet se unë nuk jam i pandershëm apo politik (fjalë që nuk kuptohet). Unë jam Martini, i njohur prej teje si (fjalë e pakuptueshme) revolucionar, megjithëse naiv. Nëse ti nuk do të interesohesh për mua, unë do të përfundoj keq.

Nuk dua ta shqetësoj prof. Malokin, përveçse për garancinë. Nuk kam frikë nga vuajtjet, por deri sa të jetoj dua të jetoj në mënyrë të ndershme. E di që situata jonë është e mallkuar dhe askush nuk mund të më ndihmojë. Megjithatë nëse bën diçka për mua, të jesh i bindur se kurrë nuk do të harrohet.

MARTINI

3.

Letra përmban shtesën e mëposhtme. Të fala dhe Urime për Vitin e Ri, firmosur nga Pastori i Beogradit PETLICH

4.

Për WASH (Uashingtonin, shën ynë), një kopje të letrës origjinale për ruajtje, së bashku me një kopje të zarfit të postuar.”

Letra e mësipërme, e ruajtur në Arkivin e CIA-s është mjaft interesante dhe komplekse. Drejtuar një personi në Romë, identitetin e të cilit ende sot CIA e ruan, duke e fshirë nga dokumenti i deklasifikuar, kjo letër ngre disa pikëpyetje të rëndësishme.

Përtej një panorame të një poeti të trishtuar, që ka humbur shpresat, a është kjo letër një përpjekje e Camajt për t'u larguar nga Beogradi, si pasojë e humbjes së besimit ndaj sponsorizuesve të vet? Për cilën veprimtari irredentiste antijugosllave flet Camaj? Përse shpreh një zhgënjim të thellë nga Instituti i Albanologjisë në Kosovë? Në botimet e tij të asaj kohe, dy libra poetikë, respektivisht "Nji fyell ndër male" (1953) Prishtinë dhe "Kanga e vërrinit" (1954) nuk ka gjurmë të irredentizmit shqiptar.

Pasi mori diplomën nga Universiteti i Beogradit, Martin Camaj aplikon për studime pasuniversitare në Universitetin e Sarajevës. Këtu ai kërkon të studiojë me profesorin kroat Baric. Tema e perzgjedhur "Gjuha e Gjon Buzukut". Kjo kërkesë u miratua nga Këshilli shkencor i fakultetit më 16 shkurt 1956 (B. Demiraj, *Jeta e akademikut M Camaj*).

Lind pyetja, nëse do të besojmë letrën e Camajt, se ai po persekutohej nga regjimi i Beogradit, si ka mundësi që i është dhënë e drejta për studim në Universitetin e Sarajevës? Një tjetër pyetje e cila mbetet pa përgjigje.

Po kështu, nuk ka asnjë të dhënë se gjatë qëndrimit të tij në Beograd, Martin Camaj të ishte përfshirë në angazhime nacionaliste. Përndryshe, si mundej që një shqiptar nationalist, irredentist, revolucionar (epitete të gjendura në letër) të punësohej në Universitetin e Beogradit, të punonte në Radio “Beograd” si dhe të ishte anëtar i një organizate politike/agjenturore të kontrolluar nga UDB-ja? Këto dy fakte të fundit nuk përmenden në letrën e tij.

Aludimi i Camajt se ishte Gjeneral Dushan Mugosha, personi i cili kishte ndaluar aktivitetin e tij letrar, është vështirë për t’u pranuar, kur qartësisht kuptohet fuqia e një Gjenerali të UDB-së, ndaj kujtdo që dyshohej si antijugosllav. Aq më shumë që Camaj ishte anëtar i Komitetit të Prizrenit dhe si i tillë sponsorizohej dhe kontrollohej nga Gjenerali Mugosha. Me shumë gjasë, Gjeneral Mugosha ka parë në figurën intelektuale të Camajt, një mundësi të artë për të depërtuar qarqet e diasporës shqiptare në Perëndim dhe si rrjedhim portretizimi i tij si një antijugosllav, pro irredentist mund të ketë qenë një tymnajë për t’i dhënë atij një alibi në qarqet shqiptare të diasporës.

Por pyetja më interesante, që del nga kjo letër, është si dhe përse shërbimi sekret amerikan ndihmon që kjo letër të dalë nga Beogradi? Çfarë e lidhte shërbimin sekret amerikan me një poet emigrant shqiptar në Beograd? Apo pyetja mund të bëhet në kahun e kundërt: çfarë kërkonte një emigrant politik shqiptar me shërbimin sekret amerikan? Aq më tepër në Beogradin e kohës, ku çdo i huaj survejohej rreptësisht dhe kontaktet ishin të vështira?

(Në arkivin e CIA-s ka disa dokumenta specifike mbi kontrollin e UDB-së ndaj Postës Jugosllave dhe në veçanti të letrave që dilnin nga Jugosllavia). A ka qenë kjo një përpjekje e Camajt për t’u shkëputur nga jugosllavët apo inskenimi i kërkimit të ndihmës me anë të letrës ka qenë pjesë e një plani të shërbimit sekret të UDB-së për ta vendosur atë në Itali pranë mërgatës politike shqiptare? Sido që të jetë e vërteta, deri sa të kemi dokumente kundërshtuese nuk mund të arrijmë në një përfundim shterues.

E vërteta është se Martin Camaj arriti të shkonte në Itali, në pranverën e vitit 1956, vetëm pak muaj nga letra e sponsorizuar nga amerikanët. Me vete kishte edhe Ninën bashkëshorten e tij serbe, për të cilën duhet thënë se sipas letres së tij dërguar nga Beogradi ende nuk e kishte zyrtarizuar këtë martesë në Kishën Katolike.

ITALI

“Ardhja e Martin Camajt në Romë më trimëroi me hy edhe njëherë në valle të botimeve. Me bashkëpunimin e tij vëllaznuer dolën në dritë “Shejzat”... Sillte me vete edhe dishka ma tepër: njomsin agimore të letërsisë së Kosmetit... E ndiente veten si pjesëmarrës i ngusht në lëvizjen kulturore t’asaj krahine... Ajo frymë më rinoi e shkaktoi në mue një ringjallje fuqish...” (“Shejzat”, 9-12, 1966, f. 308-309). Ernest Koliqi.

<p>CIA PERSONNEL (a) KOLIQUI, Ernest: from SCUTARI; an intellectual; a cabinet member who cooperated with Italian occupiers; has possible Vatican connections; and is a possible subagent to a German Intelligence agent. Subject’s son, in 1949, was reported to be in touch with the Italian Intelligence Service concerning operations against Albania. NOTs OBSTACLE is an outgrowth of CHARITY (Prior to 30 June 1952), which was a CIA operation designed to exploit a political émigré group in Rome – BKI (Blloku Kombëtar Indipendent)</p>	<p>Personel 1.a. KOLIQUI Ernest, nga Shkodra, intelektual. Anëtar kabineti, cili ka bashkëpunuar me okupatorët italianë, mundet të ketë lidhje me Vatikanin dhe mundet të jetë në varësi të një agjenti të inteligjencës gjermane. Djali i tij në 1949 ka pasur kontakte me shërbimin inteligjent italian lidhur me operacionet kundër Shqipërisë.</p>
---	--

<p>Project OBDURATE, reincarnated from OBSTACLE nee CHARITY, was approved prior to 13 September 1954 at an annual expense of (shuma e fshirë \$) The objectives as stated in the Project Outline are twofold: (1) To exploit informational sources, in Italy, and concurrently track the activities of Albanians in Yugoslavia and Italy. (2) To monitor its Albanian activities through an Albanian agent. The targets of OBDURATE are: (1) Albanian refugees in Yugoslavia (through correspondents) and Italy; (2) a a ; and, 1.-- (3) Albanian Legation in Rome.</p>	<p>Projekti OBDURATE ka lindur nga OBSTACLE dhe CHARITY dhe është miratuar më 13 shtator 1954 me një buxhet vjetor (shifra e fshirë). Objektivat janë: 1. Të shfrytëzojë burimet e informacionit në Itali dhe njëherësh të mbajë në kontroll aktivitetin e shqiptarëve në Jugosllavi dhe Itali; 2. Të monitorojë aktivitete shqiptare nëpërmjet një agjenti shqiptar. Target i OBDURATE janë: 1. Refugjatët shqiptarë në Jugosllavi (nëpërmjet korrespondencës) dhe Itali; 2. Legata Shqiptare në Romë.</p>
---	---

Dokumenti i mësipërm është një prej dokumenteve më interesante të arkivit të CIA-s, i cili bën fjalë për detaje operacionale të disa shërbimeve të inteligjencës amerikane që vepronin në Itali, si CIA, OSO dhe Shërbimi i Kundërzbulimit CI. Ky i fundit, drejtuar nga figura legjendare amerikane, James Jesus Angelton, i cili kishte ndërtuar një rrjet të fuqishëm në të gjitha nivelet e shoqërisë italiane. Angelton, që kishte

drejtuar X-2 gjatë Luftës së Dytë Botërore në Itali, kishte njohje edhe me një numër personazhesh shqiptare, nga të cilët mernte informacione paralele.

Nga një sërë dokumentesh del qartë se amerikanët, të cilët po mbanin peshën kryesore në Operacionet antikomuniste, kishin arritur të depërtonin në Mërgatën shqiptare në Itali, duke monitoruar të gjithë aktivitetin e saj. Blloku Independent, një organizatë e ngritur dhe e mbajtur më këmbë nga shërbimi sekret italian, kishte një numër emrash të njohur, të cilët kishin qenë bashkëpunëtorë ose mbështetës të Italisë fashiste. Dyshimi se Mërgata ishte depërtuar nga Shërbimi Sekret Shqiptar e bënte më të rëndësishme vendosjen e agjentëve amerikanë edhe në Bllokun Independent, për të kontrolluar çdo hap të saj.

Në të njëjtën valë operacionale ishin jugosllavët, të cilët të angazhuar në operacionet e tyre anti-Hoxha kërkonin edhe ata të depërtonin jo vetëm në Komitetin "Shqipëria e Lirë", por edhe në Bllokun Independent, që mbronte politikën italiane kundrejt Shqipërisë. Në këtë atmosferë të luftës midis shërbimeve sekrete, mbërrin në Romë nga Beogradi Martin Camaj, i cili duket të ketë qenë nën vëzhgimin e Operacionit OBDURATE.

Nga letra e Camajt sjellë në këtë shkrim, nuk kuptohet saktë nëse sponsorizuesit e tij për mbërritjen në Romë, janë të njohurit e tij nga koha e seminarit jezuit të Shkodrës.

Megjithatë, duket se një prej personaliteteve më të rëndësishme kulturore të diasporës shqiptare dhe mbështetës i tij në Romë ishte **Ernest Koliqi**. Ky supozim del edhe nga dokumenti i mëposhtëm, i cili edhe pse emrin e agjentit të rekrutuar e ka të fshirë, nuk është vështirë të kuptohet se kush është. Studiuesi në fjalë ishte një prej agjentëve kryesorë të CIA-s, i cili kishte si detyrë monitorimin e diasporës shqiptare në Jugosllavi. Në këtë kontekst mund të supozojmë me siguri se personi të cilit i drejtohej letra e Camajt nga Beogradi dhe sponsorizuesi kryesor i ardhjes së tij në Romë duhet të ketë qenë Koliqi.

b. [redacted]: Subject began his career as a scholar and became one of the foremost poets writing in the Albanian language, as well as the leading authority on that language's origins, before he became interested in politics. Because of his Catholic religion and long education in Italy, he was a strong supporter of Albania's "Union" with Italy and held cabinet rank during the Italian occupation of his native country. Despite this history of collaboration with the Italians, he remains an influential figure in North Albania.

Cover:

a. [redacted] and [redacted] as leaders of the BKI emigre group live overtly in Italy where they enjoy the official protection of the Italian Government. No cover is therefore necessary.

b. The CIA case officer is known to above subjects by his true name and as a representative of this agency. His contact has been surprisingly secure in view of its long duration (since mid-1948).

Por ardhja e Camaj në mesin e komunitetit shqiptar të Romës duket se nuk ka qenë edhe aq e lehtë. Sipas një raporti të Zbulimit Politik Shqiptar, Camaj është dyshuar si njeri i dërguar nga komunistët, por ka qenë këmbëngulja e Koliqit që e ka ndihmuar për të kapërcyer këtë dyshim. Dyshim i mbështetur nga një figurë e njohur e veriut si Gjon Marka Gjoni.

MARTIN CAMAJ 36

Ka lindur ne katundet e Dukagjinit. Ka reth 35 vjec. Pa
ka pase studjue ne shkellen e priftrave katolik. Ky ka ikur nga Shq
peria per ne Jugosllavi. Ka stjuar ne universitete te Jugosllavise
dhe atje eshte martuar me nje studente serbe dhe tash jane stabili
zuar ne Reme. Me perkrahjen e E. Koliqit dhe te priftit Daniel
Gjecaj, eshte emnuar ne fakultetin e gjuhes shqipe ne Universitetin
e Romes. Ky ne bashkepunim me Koliqin nxjerr revisten "Shejzat" ne
sherbim te kishes katolike. Ne ditet e para te ardhjes se tij ne
Rome nga Jugosllavia nuk ka qene i mirpritun nga katoliket shqipta
re dhe sidomos nga ana e Gjon Marka Gjonit, ka qene i akuzuem si
komunist, per me ndihmen e priftit Daniel Gjecaj dhe Koliqit i ka
kaperxyer te gjitha dyshimet.

9.8.

U nxuar nga raporti i "50" date 8.9.1960
prej M. zikes me 18.10.1960.....

Informacioni i dokumentit te Zbulimit Inteligjent Shqiptar sjell një të dhënë shumë interesante e cila kërkon vëmendje në analizën tonë. Përse komuniteti katolik në Romë ka dyshime mbi poetin e ri Camaj? Mos vallë lehtësia e ardhjes së tij nga Jugosllavia? Bashkëshortja serbe e cila gjithashtu kishte marrë miratimin e autoriteteve pa asnjë pengesë? Shkollimi tij në universitetin e Beogradit apo roli në Radio Beograd e bënte atë një figurë të papranueshme për Kapidanin e njohur të Mirditës?

Ndoshta të gjitha këto arsye bashkë, por ajo që është mjaft me interes mbetet mbështetja e Ernest Koliqit dhe e Pader Daniel Gjecaj (Mark) i njohur si "Miku i Maleve", në dokumentin amerikan për Komitetin e Prizrenit. Në këtë kontekst në analizën tonë nuk mund të mos përmendim edhe një fakt shumë interesant i cili ka të bëjë me rolin që Inteligjenca jugosllave luante në gjirin e Mërgatës Shqiptare. Në periudhën e operacioneve të Shërbimit amerikan kundër Shqipërisë, në dokumentacionin e kundërzbulimit amerikan OSO, flitet për një mundësi bashkëpunimi me një organizatë të vogël por shumë sekretive e quajtur "Lidhja e Maleve". Kjo organizatë e përbërë kryesisht nga priftërinj të arratisur dhe disa pronarë të mëdhej tokash nga malësia e veriut ishte jo vetëm një organizatë antikomuniste por edhe thellësisht antijugosllave. Për këtë arsye amerikanët nëpërmjet OSO (të drejtuar nga J.J Angelton) dhe OPC (drejtuar nga Frank Wisner një nga arkitektët e operacioneve anti Kastro) propozojnë një bashkëpunim me "Lidhjen e Maleve".

Këto operacione do të siguronin një pavarësi operacionale në terren pa mbështetjen (dhe pa kontrollin) jugosllav. Duke parë rëndësinë e madhe që kjo organizatë mund të kishte në Malësi, të tërheq vëmendjen fakti se Inteligjenca Shqiptare vëzhgonte disa nga drejtuesit e "Lidhjes se Maleve" Në Dosjen e kundërzbulimit shqiptar gjendet edhe një foto e liderit të kësaj organizate Pater Zef Oroshi me Nina Bogdanovich Camaj. Pader Zef Oroshi një famullitar që shërbente në fshatin Ungrenj, sipas dokumentacionit të Sigurimit të Shtetit, në mars të vitit 1951 në zonën katolike të Mirditës, ishte përpjekur për të ngritur këtë zonë kundër pushtetit komunist.

Nuk është shumë e qartë në se kjo tentative kishte qënë një përpjekje reale apo një sajesë e Sigurimit të Shtetit, por duket se Pader Zefi ishte larguar për në Jugosllavi. Prej këtej, me ndihmën e Kapidanit të Mirditës Gjon Marka Gjonit, kishte emigruar në Itali. Me sa duket aktiviteti i tij politik në Itali vëzhgohej nga Shërbimi Sekret Shqiptar, por me shumë gjasë, organizata që ai drejtonte ishte objekt penetrimi i UDB-së jugosllave.

Në këtë kontekst mund të ngrejmë pyetjen se përse Koliqi, Camaj dhe Pader Daniel (Mark) Gjecaj (ky i fundit anëtar i grupit konsultativ të Komitetit të Prizrenit) kishin marrëdhënie me Pader Zef Oroshin, Liderin e “Lidhjes së Maleve”?



(Pader Zef Oroshi dhe Nina Bogdanovich Camaj)

Koliqi ishte një personalitet kulturor i njohur i kohës. Ministër Arsimit në kohën e pushtimit fashist, ai kishte ndërmarrë një akt të rëndësishëm në dobi të Kosovës: hapjen e shkollave shqipe në territoret kosovare, vepër kjo për t’u lavdëruar.

Besnik i idesë së një bashkëpunimi me Italinë, ai mbahej si një prej personaliteteve me filoitaliane të kohës. Gjatë periudhës dyvjeçare kur ai drejtoi Ministrinë e Arsimit, kultura shqiptare dhe shkrimtarët shqiptarë njohën një mbështetje të madhe, por nuk do t’i bënim një shërbim historisë, nëse nuk do të theksonim edhe një fakt, i cili është lënë në heshtje nga të gjithë biografët e tij:

Dëmtimi i bibliotekës së dhuruar nga Lady Carnarvon për rrinë shqiptare, në kujtim të djalit të saj, Herbert. Vepër që u krye në Tiranë, gjatë periudhës kur Koliqi ishte Ministër i Arsimit dhe Italia i kishte shpallur luftë Anglisë. *“Librat e kësaj biblioteke, dhuruar nga Lady Carnarvon, u dogjën apo u shpërndanë majtas apo djathtas me qëllimin e vetëm që ta zhduknin atë”* (M.Kuteli, *Bashkimi i Kombit 1944*)* (A.Plasari 2014).

Me kapitullimin e Italisë në 1943, Koliqi u largua nga Shqipëria dhe u vendos në Vatikan si ambasador. Pas Luftës pati një aktivitet të rëndësishëm letrar, veçanërisht në Universitetin e Romës. Por aktiviteti më i rëndësishëm i Koliqit në këtë periudhë, ishte fakti se ai qe ideologu dhe drejtuesi i Bllokut Independent Kombëtar, organizatës politike proitaliane, për të cilën interesoheshin shumë si CIA amerikane, si UDB-ja jugosllave.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi i Martin Camajt me Koliqin nuk do të ketë qenë krejt i rastësishëm. Bashkëpunimi i tyre, i nxitur edhe nga interesimi për letërsinë, duhet të kenë pasur në sfond edhe një bashkëpunim në fushën e inteligjencës. Më shumë interes është pyetja nëse vendosja e Martin Camajt në Romë ishte një mision për të depërtuar BKI-në në dobi të jugosllavëve? Apo “Brezi i Kuq” kishte mision diasporën shqiptare në Itali?

Më poshtë mund të lexojmë disa të dhëna, të marra në rrugë operacionale nga shërbimi i kundërzbulimit amerikan, i drejtuar nga Angelton, që vepronte në Itali.

8/ “më 9 korrik 1954, një raport nga terreni raportoi me detaje një kontakt të (emri i fshirë) të një dyshimi të bashkëpunimit me Shërbimin Iteligjent Gjerman. Një shoqëri e datuar që **prej 1943** e deri më sot u zbulua. Natyrisht (emri i fshirë) e kundërshtoi me një zemërim faktin se mund t’i kishte dhënë informacione Shërbimit Gjerman. Gjithsesi, ky zhvillim ngre një sërë pyetjesh. Efektivisht, (emri i fshirë) a përfaqëson

një “fabrike letre” të vogël private? A është informacioni që marrim nga ky burim thjesht fabrikim i gatshëm për çdo blerës? Aktualisht çfarë kontrolli kemi ne ndaj (emri i fshirë)? Sa shumë dimë ne konkretisht për marrëdhëniet e (emri i fshirë) me (emri i fshirë)? A jemi ne të kënaqur me shpjegimet (emri i fshirë) për një miqësi që nga koha e luftës?

9/ Problemi i kontrollit është si ai ??? zgjidhet rrallë, kur merremi me figura politike apo parti apo ato që më së shumti ata i quajnë nën/agjentë.

15/ deri në çfarë pike Komiteti Shqipëria e Lirë është depërtuar nga Shërbimi Sekret Shqiptar? Në këtë drejtim, çfarë dimë ne për KODRA, MUFTI dhe BINERI, të cilët nuk pranuan të ishin agjentë të SHYTI, por që aludohet se janë agjentë të kolegëve të SHYTI-t?

Dokumenti i CIA-s është shumë interesant, i mbushur plot me detaje, ku ka një sërë emrash të diasporës shqiptare në Itali, të cilët survejoheshin nga kundërzbulimi amerikan si agjentë të mundshëm të Sigurimit Shqiptar (përfshirë edhe Ibrahim KODRËN). Amerikanët ishin shumë të shqetësuar se Komiteti Shqipëria e Lirë ishte depërtuar nga kundërzbulimi shqiptar dhe merrte informata mbi planet e Kompanisë 4000, që po trajnohej nga amerikanët në Mynih. Por në morinë e detajeve që përshkruhen në këtë dokument, të tërheq vëmendjen shqetësimi i amerikanëve që burimi i tyre në Bllokun Independent ishte një burim jo shumë i besueshëm, i cili fabrikonte informata për blerësin më të parë. Emri i fshirë i këtij burimi e bën edhe më intrigues faktin që amerikanët dyshonin për një prej agjentëve të tyre, që e kishin në Bllokun Kombëtar Independent.

Por kush ishte ky personazh? Kush ishte personi që punonte për italianët, u shiste informata të dyshimta amerikanëve, kishte kontakte me shërbimin sekret gjerman që në vitin 1943? Një sërë dokumentash të deklasifikuara nuk e tregojnë emrin e këtij personazhi, por dokumenti i mëposhtëm i kundërzbulimit, i gjendur në Dosjen e Operacioneve të OSO (shërbimi i kundërzbulimit amerikan) kundër Shqipërisë, hedh dritë përfundimisht mbi identitetin e personazhit enigmatik.

Subject: Plan LABLAZE

Report No: 0 // e - 7367.

Progress Report Place Acquired:

Evaluation: C-3

Burimi: (fshirë)

Data e Raportimit: 12 January 1954

Më 30 tetor 1953, siç është raportuar më parë, Drejtori i Qendrës së Mynihut, Schultz, mbërriti në Romë në orën 07.45. Mbas një serie takimesh, u largua për në Mynih po atë natë.

Në renditje kronologjike Schulzi kishte këto takime:

1. Ministria e Brendshme së bashku me KARL HASS

2. Ministria e Mbrojtjes (raport i gjatë)

3. Takimi me KOLIQI (komenti i kontrollit): (Ernesto KOLIQI i Bllokut Independent Kombëtar, kontaktet e të cilit me Shërbimin Sekret Gjerman janë të njohura) pati një takim të gjatë midis Koliqit dhe HASS. Shërbimi i Bonit është shumë i interesuar për çështjet shqiptare. (Komentet e kontrollit: Interesa direkte, që në kohën kur Kaizeri vendosi në Fronin e Shqipërisë princ Vidin apo interesa të nxitura nga humbja e pozicionit mes refugjatëve shqiptarë nga Shërbimi Inteligent Gjerman). Në fakt HASS supozohet se pengon penetrimin amerikan. Gjithsesi, atij i duhet të bëjë

veprime antiitaliane. HASS mori urdhër nga SCHULTZ që të fillojë të vendosë bazat për një depërtim të thellë gjerman në këtë sektor. HASS ka marrë urdhër që të depërtojë informatorët shqiptarë të Shërbimit Amerikan. Ishte në këtë frymë që u organizua takimi KOLIQI-SCHULTZ.

KOLIQI, i cili përpara mbërritjes së SCHULTZ ishte konsultuar, me kërkesën e HASS, me liderët kryesore të grupit politik të Koliqit (Verlaci, Markagjoni etj.) i tha SCHULTZ se si AI personalisht, por edhe si përfaqësues i grupit të tij, ishte i gatshëm të pranonte një bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin e ri të Inteligjencës Gjermane me kushtet e mëposhtme:

a/ Trajtimi ekonomik duhet të jetë, siç është aktualisht trajtimi i dhënë nga Shërbimi Sekret Amerikan (250 usd në muaj) dhe

b/ Qeveria Gjermane të japë një formë njohjeje politike ndaj grupit, të cilin ai përfaqëson, njohje që deri më tani i është mohuar nga Shërbimi Amerikan.

KOLIQI theksoi gjithashtu se për çdo bashkëpunëtor të tij, (kërkonte) të kompensohej me **një pagë mujore prej 100.000 lira**. Po kështu theksoi se ai ishte i gatshëm të bashkëpunonte me Shërbimin Gjerman edhe në sektorë të tjerë si ai Bullgar, Kroat dhe Rumun. Për sa i përket marrëdhënieve midis Qeverisë Italiane dhe asaj të Tiranës, me kërkesën eksplicite të SCHULTZ, KOLIQI deklaroi se ai ishte në dijeni nëpërmjet dokumenteve se këto marrëdhënie ishin përmirësuar kohët e fundit, si një reflektim i tensioneve Itali-Jugosllavi.

SCHULTZ iu tha mbështetjen e interesimit të tij për situatën shqiptare në përgjithësi dhe refugjatëve shqiptarë në Itali. Privatist SCHULTZ-i i dha mbështetjen e tij HASS-it që të gjitha burimet financiare do të ishin në dispozicionin e tij, për të zhvilluar aktivitete në sektorin e Shqipërisë.

Raporti i 7 nëntorit 1953.

Më 2 nëntor 1953 në orën 11.30, HASS u prezantua nga Ernesto Koliqi me At Gagovin, siç është raportuar edhe me përpara në qendrën e Françeskanëve në Romë, Via Guido Baccelli 56. Ky ishte zhvillimi i parë që prej takimit SCHULTZ-KOLIQI. At Gagov mori në konsideratë me shumë kënaqësi bashkëpunimin me Shërbimin Sekret të Bonit, kundër komunistëve në Bullgari. Detaje të rëndësishme: për të aktivizuar këtë bashkëpunim GAGOV-i paraqiti mundësinë e sjelljes nga Kanadaja të disa bullgarëve të cilët nuk janë të kompromentuar në qarqet e emigracionit bullgar në Itali. (komentet e kontrollit) (oficeri përgjegjës për operacionin Shën ynë): Duhet të bëhen përpjekje për ta penguar këtë, pasi GAGOV është një agjent britanik, që në takimin e parë GAGOV i ofroi HASS-it bashkëpunimin e disa të tjerëve:

a/ një Kolonel rumun, të cilit HASS nuk ia di emrin apo nuk do të na e thotë për sektorin rumun.

b/ një farë Fabian për sektorin bullgar (komenti i kontrollit: janë shumë persona me emrin Fabian, duhet kërkuar për identifikimin e këtij personi).

c/ Një farë XHEDIC për sektorin Kroat (komenti i kontrollit: Ky është Krilic, dora e djathtë e Ante Pavlic).

7/ Nga ky moment HASS do të ketë kontakte të drejtpërdrejta me At Gagovin. Çështja është në ndjekje.

Dokumenti i kundërzbulimit amerikan ka një mori faqesh të mbushura me detaje shumë interesante, ku emri i Koliqit del herë pas here në operacione spiunazhi ndërkombëtar. Por pyetja e parë që çdo lexues do të ketë kur lexon këto radhë është, kush ishte KARL HASS, miku i Ernest Koliqit që nga viti i largët 1943?

Dokumentacioni i deklasifikuar amerikan tregon se Karl Hass ishte

Sturmbannführer Karl Hass, SS numri i regjistrit në Partinë naziste, 117 557.

Oficeri i lartë i zbulimit politik SD të Partisë naziste Gjermane.

Karl Hass, i cili ishte përfshirë në Organizatën e Shërbimit Sekret të Partisë naziste SD, që me 1934, ishte graduar Shefi i SD në Romë më 1943. Falë bashkëpunimit me Gestapon, kishte ndërtuar një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh sekretë, që raportonin për llogari të inteligjencës naziste. Pas kapitullimit gjerman kishte jetuar disa kohë i fshehur në malet e Tirolit, së bashku me nazistin famëkeq Erik Priebke, i nxjerrë në gjyq në vitet '90. Karl Hass është akuzuar nga autoritete Izraelite për dërgimin e rreth 1 mijë hebrenjve italianë në Auschvic si dhe për masakrën e 335 civilëve italianë në shpellat ardeatine! Në vitin '46 iu dorëzua autoriteteve amerikane dhe pranoi të punonte për shërbimin e kundërzbulimit amerikan CIC. Në të njëjtën kohë, ishte i përfshirë në rrjetin e Organizatës për oficerët SS për evakuimin e tyre drejt Amerikës Latine. Hass u mor në shërbim nga "Organizata Gehlen", shërbim sekret gjerman, i financuar nga amerikanët, që kishte objektiv Bashkimin Sovjetik dhe më vonë ishte baza e Shërbimit Sekret Gjermanoperëndimor BND. Karl Hass, sipas dokumenteve të Shërbimit Italian, ishte personi që mbulonte Jugosllavinë dhe Shqipërinë, për llogari të Shërbimit Gjerman. Me sa duket nga dokumenti ynë, Hass vazhdonte të raportonte për llogari të kundërzbulimit amerikan, një shërbim ky gati i pavarur, që drejtohej nga Angelton dhe konsiderohej një shërbim shumë efikas me burime të shumta.

Me të drejtë, në analizën tonë lind pyetja se çfarë e lidhte shkrimtarin Ernest Koliqi me një oficer të shërbimit politik nazist, aq më shumë që prej '43-shit? A ishte vallë Hass një admirues i shkrimeve të Koliqit? Apo mos vallë Koliqi kishte qenë pjesë e rrjetit të ndërtuar nga Karl Hass në Romë, me ndihmën e Gestapos?

Nje detaj shumë interesant që hedh dritë sado pak në këtë pikëpyetje vjen nga dëshmia e shkrimtarit Petro Marko. I arrestuar në Romë nga Gestapoja gjermane, Marko lihet i lirë 'pas një telefonate të Ernest Koliqit'. Petro Markoja shkruan në kujtimet e tij se "Ernest Koliqi e kishte ndihmuar në Romë, kur gjendej i arrestuar në burgun e Regina Coeli-it dhe priste të pushkatohej tek Fosse Ardeatine". Fosse Ardeatine në fakt ishte vendi ku Gestapo Gjermane pushkatoi 335 civilë italianë. Masakra më e madhe gjermane mbi popullsinë civile në Italinë e Luftës së Dytë.

Kjo masakër (së cilës i është kushtuar një Muze i rëndësishëm nga Qeveria Italiane) e tronditi rëndë popullatën e Romës duke përfshirë edhe personalitetet më të rëndësishme të kohës, të cilët ndërhyjnë pranë autoriteteve gjermane për të ndaluar vrasjet e civilëve. Vetë Papa ndërhyri pranë Mareshalit gjerman Keslinger, Komandant i trupave gjermane në Itali për të shpëtuar të burgosurit. Megjithatë 335 civilë u pushkatuan në Shpellat Ardeatine. Petro Marko duhet të ketë qenë me shumë fat që mesuesi i tij i dikurshëm i shpëtoi jetën. Por si mundi Ernest Koliqi të shpëtonte nxënësin e tij?

March 24, 1944, personnel from the headquarters of the Security Police and SD in Rome, led by SS Captain Erich Priebke and SS Captain Karl Hass, assembled 335 Italian male civilians near a series of man-made caves on the outskirts of Rome on the Via Ardeatina. The *Fosse Ardeatine*, or Ardeatine Caves, were the remnants of ancient Christian catacombs, and served as a convenient venue to carry out the reprisal shootings in secrecy and to conceal the bodies of the victims.

Duket se Kapiteni SS Karl Hass “miku i Koliqit që nga viti 1943” ishte një nga dy oficerët që ekzekutuan civilët Italianë në Shpellën Ardeatine. Për këtë krim të rëndë Gjykata Ushtarake e Romës edhe në moshën 92 vjecare e dënoi me 10 vjet e 8 muaj burg.

On 22 July 1997, the Military Court of Rome found Hass guilty of crimes against humanity and consequently sentenced him to ten years and eight months of imprisonment

Takimi i Koliqit me Shefin e Shërbimit Gjerman Schultz, sjell për lexuesin një këndvështrim të ri krejtësisht të panjohur të këtij intelektual shqiptar. Siç shihet nga ky dokument, në takimin e parë midis Koliqit dhe shefit të GIS-it nuk ka asnjë bisedë parimore, intelektuale apo patriotike ndaj çështjes shqiptare apo asaj kosovare.

Kërkesat janë sipas prioritetit:

1. një pagesë mujore 250 USD (rreth 2400 USD me të sotmet);
2. kërkesa e vagullt për një njohje politike të BKI;
3. kërkesa tjetër për një pagë mujore për çdo bashkëpunëtor, që ai sillte në tavolinë për interes të shërbimit gjerman. Ofrimi i tij si rekrutues për informatorë të tjerë rumunë, bullgarë e kroatë për llogari të shërbimit gjerman, hap një dritare të re për të parë me kujdes marrëdhëniet që Koliqi do të kishte me shkrimtarin Camaj.

Me të drejtë mund të pyesim: a ishte bashkëpunimi i tyre një bashkëpunim midis letrarësh apo Camaj u bë informator i Koliqit për shërbimin italian, ku Koliqi kishte vite i punësuar; për atë amerikan, i cili e konsideronte Koliqin një “fabrikë private letrash”; apo për shërbimin gjerman, me oficer kontakti ish-oficerin e SD gjermane Karl Hass?

Po sikur UDB-ja jugosllave, duke ditur kontaktet e Koliqit t’i kishte sjellë pranë një njeri të saj, që do ta mbante atë nën kontroll? A ishte Koliqi një rekrutues informatorësh apo pa pasur dijeni kishte rënë në rrjetën e UDB-së?

Për të kuptuar se në çfarë ujërash notonte Koliqi, le të lexojmë më poshtë se çfarë thotë kundërzbulimi amerikan në raportin e tij për Karl Hass.

Vazhdon

14. Nga të gjitha këto ngjarje HASS nxori këto konkluzione: ishte e rëndësishme që ai të merrte kontakte urgjente me Shërbimin Sovjetik, për të shitur sot në avantazhin e tij informacionin që shefi i tij mund t’ua shiste sovjetikëve apo të tjerëve nesër.

15. Hass raportoi se kishte pasur një takim të shkurtër për këto ngjarje me Massimo UFFREDUZZI. UFFREDUZZI e siguroi HASS për stabilitetin e pozicionit të tij, duke i deklaruar se SIFAR-i do bëjë gjithçka, që ai të vazhdojë të mbajë pozicionin e ndërmjetësit midis Romës dhe Bonit. (SIFAR shërbimi sekret ushtarak italian)

16. Në Orën 10.25 në nëntor të 1953-shit, HASS mori një komunikim nga Linz prej Alois EDER, komunikim që u pa nga burimi. EDER njoftonte marrjen e një raporti ushtarako-politik mbi situatën në Shqipëri. Ai theksonte se i kishte treguar një të ashtuquajtur PETER, (nuk është identifikuar) anëtar i forcës policore austriake në Linz.

17. **HASS i dërgoi EDER-it material të inteligjencës mbi Shqipërinë, të marrë nga Koliqi për t’iu ofruar blerësit që ofronte më shumë.** Ky episod tregon sesi HASS – dhe jo vetëm ai – është i përfshirë në tregtinë e materialit të spiunazhit, të cilin ai e mbledh nga të gjitha fushat.

19. Raport më 27 Nëntor 1953. Në ora 10.20, 25 nëntor 1953, HASS hyri në Zyrën e Përfaqësuesit Tregtar Sovjetik.

21. Pasi kishte bërë prezantimin se kush ishte, të kaluarën dhe aktivitetin e tij si Major i SD (zbulimi politik nazist), bashkëpunëtor i Shërbimit Sekret Amerikan, ndërmjetës midis Bonit, Romës dhe SIFAR-it, HASS bëri ofertën e mëposhtme për Shërbimin Sekret Sovjetik:

a/ të gjitha materialet e spiunazhit, që vijnë nga pozicioni i tij si ndërmjetës midis Bon-it dhe SIFAR-it (ai ofroi material në takimin tjetër, fotokopje të korrespondencës Bon-SIFAR)

b/ **depërtimi nëpërmjet tij i mërgatës antikomuniste shqiptare dhe bullgare.**

c/ depërtimi në Egjipt, nëpërmjet miqve të tij SD, banues atje (përmendi një udhëtim në Kajro).

d/ Raportim për aktivitetin e ish-Mbretit Faruk

22. HASS specifikisht u tha sovjetikëve se e bënte këtë vetëm për para dhe ai kishte një njeri shumë të besuar, që do ta përdorte për mbajtjen e kontakteve (burimi ynë). 45/ bashkëngjitur një kopje fotografike e përkthimit italisht e letrës së SCHULTZ-it për Kolonelin ROSSI.

b) *Photographic: Kopje e dy raporteve në gjermanisht*

Alois EDER, një tjetër ish-oficer i shërbimit sekret gjerman SD ka një dosje interesante në arkivin e kundërzbulimit amerikan: i rekrutuar pas lufte nga amerikanët, EDER mbante lidhje me sovjetikët dhe kalonte materiale sekrete nëpërmjet Vjenës për GRU, shërbimin ushtarak sovjetik. Por ajo që bie në sy në këtë raport të gjatë, është fakti se Karl Hass, miku i vjetër i Ernest Koliqit, ishte një agjent, i cili raportet politike të marra nga Koliqi mbi çështjet shqiptare, jo vetëm i nxirrte në treg për të siguruar blerës të mundshëm, por duket qartë **se një prej klientëve të tij ishte shërbimi sekret sovjetik KGB.** A kishte dijeni Koliqi se raportet e tij binin në dorën e KGB-së, e cila me shumë gjasa i përcillte në Tiranë? Në dritën e këtyre dokumenteve me vlerë të madhe historike mund të shikojmë një figurë krejt tjetër të intelektualit Koliqi. Në këtë këndvështrim duhet parë edhe bashkëpunimi i gjatë i Koliqit me Martin Camajn, i cili pas ardhjes në Romë ishte një prej bashkëpunësorëve me të ngushtë të tij.

Nuk ka asnjë dyshim se Koliqi ishte në qendër të një aktiviteti të rëndësishëm spiunazhi në Romë. Si informator i tri shërbimeve sekrete, si rekrutues si dhe kontribues i materialeve me interes të cilat i kaloheshin KGB-së sovjetike të paktën nga dy burime: Karl Hass dhe Alois EDER.

Të dyja këto personazhe naziste të lidhura me Koliqin ishin të përfshira në çështjen e Otto John-it, shefi i shërbimit gjerman të viteve '50 dhe arratisjen e tij në Bashkimin Sovjetik.


Në një letër të interceptuar nga amerikanët, lexohet shqetësimi që të dy këta agjentë gjermanë kanë nëse emri i tyre do të dalë në listën e informatorëve sovjetikë. Qenia e Koliqit në këtë rrjet spiunazhi duhet parë në kontekstin e kohës. Në qershor të '53-shit, me gjithë operacionin e CIA-s për mbështetjen e kristian-demokratëve, ata humbën 43 vende në Parlament. E majta siguroi 218 vende, duke krijuar një gjendje paniku në zyrat e CIA-s, pasi sipas William Colby-t, shefi i ardhshëm i CIA-s, i përfshirë në operacionet sekrete në Itali “**votat e përbashkëta të socialistëve dhe komunistëve mund t'i bënin ata forcën me të madhe politike në Itali**”, (*Operation Gladio: The Unholy Alliance between the Vatican, the CIA, and the Mafia*).

Për këtë arsye amerikanët hodhën hapa konkretë. Një prej njerëzve të besuar të Allen Dulles (shefi i CIA) erdhi urgjent në Romë.

Carmel Offie, një personazh mjaft enigmatik me origjinë italiane dhe bashkëthemelues i Komitetit “Shqipëria e Lirë”. Offie kishte operuar në Itali gjatë luftës, si pjesë e shërbimit sekret amerikan OSS. Pas 1945-ës kishte qenë pjesëtar në

Operacionin “Paperclip”, operacion që kishte të bënte me nxjerrjen e shkencëtarëve nazistë nga Europa dhe sjelljen e tyre në Amerikë. Ai ishte edhe njëri prej oficerëve që u morën me krijimin e idesë së operacionit klandestin kundër Shqipërisë – Komiteti Shqipëria e Lirë – dhe sponsorizuesi kryesor i caktimit të Hasan Dostit në krye të saj. Njohës i mërgatës shqiptare në Amerikë dhe në Romë. Tashmë me një mision të ri, caktimin e një drejtuesi pro-CIA, për shërbimin e fshehtë ushtarak Italian “SIFAR”.

Me ndihmën e Shefit të Zyrës së CIA-s në Romë, Gerry Miller, dhe Ambasadorit Claire Boothe Luce, arritën të vendosin në këtë post gjeneralin Giovanni de Lorenzo. Prej këtij mori udhë edhe Operacioni i famshëm *Gladio* (manipulimi i zgjedhjeve të 1958) dhe ndërtimi i bazës sekrete të CIA-s në Sardenjë. Në këtë kontekst mund të vendoset lidhja e Koliqit me Majorin nazist Karl Hass, i cili ishte ndërmjetësi i Shërbimit Sekret Gjerman dhe SIFAR-it. Përtej depërtimit të mërgatës politike shqiptare ka shumë mundësi që si jugosllavët ashtu edhe sovjetikët kërkonin burimet e tyre për të depërtuar në SIPAR. Hass, miku i vjetër i Koliqit, ishte një prej këtyre burimeve.



Ndërkohë, me kalimin e Camajt në Romë, emri i tij nuk del më në raportet e CIA-s. Të paktën në dokumentet e deklasifikuara deri më sot. A mos vallë amerikanët e kishin humbur interesin për letrarshin shqiptar që vinte nga Beogradi? Camaj ishte tashmë jo vetëm një person i angazhuar në Mërgatën shqiptare të Italisë, por edhe Kryeredaktor i revistës kulturore “Shejzat”. “Shejzat” ishin një bashkëpunim i ngushtë me Koliqin, duke i dhënë atij edhe emër në mërgatë; por duke pasur parasysh rolin e Koliqit në këtë periudhë shtrohet pyetja: cili shërbim sekret e ka financuar këtë revistë kulturore? Nga të dhënat e botuara pas viteve ‘90, në disa prej dokumentave të deklasifikuara del qartë se “Shejzat”, ashtu si edhe disa botime të tjera shqiptare, financoheshin nga një fond sekret i shërbimit amerikan i njohur si Exile Policy Division.

While still in existence, FEC’s Exile Policy Division also supported in whole or in part the following publications: *Baltic Review* and its Spanish edition *Revista Baltica*, published by the Committee for a Free Lithuania, *Romania*, by the Rumanian National Committee, *Shqiptari i Lire*, by the Free Albania Committee, *Shejzat*, by an Albanian exile group in Rome, *Free and Independent Bulgaria*, by the Bulgarian National Committee, *Híradó* (New York), by the Association

*

The **CIA-Funded Secret Western Book Distribution Program Behind the Iron Curtain** Alfred A. Reisch ... by the Rumanian National Committee, **Shqiptari i Lire**, by the Free Albania Committee, **Shejzat**, by an Albanian exile group in Rome, ...

Me këtë informacion mbi botuesin e vërtetë të revistës kulturore “Shejzat”, do ta kishim shumë të vështirë të pranonim se amerikanët nuk e dinin se çfarë aktiviteti kryente poeti i ardhur nga Jugosllavia. Me mbështetjen e Koliqit dhe nëpërmjet “Shejzave” ai mund të operonte në të gjithë mërgatën politike shqiptare duke mbledhur informacion të vlefshëm.

Por pyetja me interesante është se ku shkante ky informacion? Për gjermanët? Amerikanët? UDB-në apo, nëpërmjet miqve të Koliqit, për KGB sovjetike?

Në informacionin e mëposhtëm të siguruar nga Agjenti shqiptar “50” del se Camaj me kujdesin e Koliqit paguhej rregullisht edhe nga italianët. Lind pyetja përse italianët duhej të paguanin një refugjat shqiptar pa asnjë kontribut të njohur proitalian? Aq më shumë kur përkrah emrit të Camajt lexohet qartë emri Kol Bib Mirakaj, ish-Sekretari i Partisë Fashiste në Shqipëri, dhe Gjon Gjinaj, lider i një grupi agentësh proitalianë që vepronin në Veriun e Shqipërisë? Nëse Kol Bib Mirakaj i kishte shërbyer Italisë në periudhën e fashizmit dhe Gjin Gjoni në operacionet klandestine të viteve 49-59, me çfarë arsytimi shpërblehej Martin Camaj?

26 15

Gjon Gjinej, Kol Bib Miraka dhe Martin Camaj me ndërmjetësinë e Koliqit, ju është caktuar dhe marrin roge të rregullta mujore nga Ministrija e Punëve Jashtme italiane. Që të tre këta, mbasi marrin njëftin në fund të odës nga jehonja të hollat në bengen komerciale të Romës. Kjo kashkaktuar pakenaqesi në disa emigrante të tjere jo katolike, të cilët e konsiderojnë veprimin e Koliqit si një formë diskriminacioni që ju bëhet atyre, duke thënë ndër të tjera, se Koliqi interesohet me shumë për katolikët dhe vetëm për njerzit e tij.

U nxuare nga rap. i "50" date 10.XI.
1958 prej H. Zikeme 13.2.1959

E ndërkohë që Camaj zhvillonte aktivitetin e tij në Itali, “miqtë” e tij të dikurshëm të Sigurimit Shqiptar nuk e kishin harruar. Nëpërmjet raporteve të agjencurës shqiptare në Itali ne mund të ndjekim aktivitetin e Camajt, si dhe bindjen që Inteligjenca Shqiptare kishte për të, se ai vepronte për llogari të UDB-së dhe Inteligjencës Gjermane. Zbulimi Politik Shqiptar e mbante nën vëzhgim duke siguruar të dhëna të hollësishme që nga adresa e banimit.

MBI MARTIN CAMAJ Bahon në Via delle Robine nr.43 (Cento Celle) tel:280-

Apo korrespondenca që ai kishte me persona të ndryshëm.

MARTIN CAMAJ Nga fillimi i qersherit Martin Camaj ka mare nje leter nga Jugosllavia nga nje shqiptar qe nuk e mora dot vesh emerin, me tre goj Vuncani, ai shqiptari eshte perkthyes nga shqipja ne gjuben jugoslave te te gjitha gazetave e librave shqiptare, eshte prane UDBse. Ne leter i thote se revista "Shenjezat" e Koligjit eshte treguar shume interesant ne zyren e tij, me shume se gazetate e tjera qe mbrijne atje. Thote se shqiptaret atje, ato pak kopje qe mbrijne, i kopjojne krejt dhe ja u dergojne njeri tjetert per ti lexuar. I thote te vazhdojne me revisten se eshte tue ba propagande te madhe. Koliqi atje dergoi 10 kopje, por nuk kalojne te gjitha mbasi i mer qeveria jugosllave.

Revista "Shenjezat" del ne regull, ju dergojne pare shqiptaret nga Amerika. Ketu revisten e ndihmon deputeti Cassiani-itala shqiptar (ish minister i marines tregtare).

U nxuar nga raporti i "67" date 13.VII. 1959 prej M.Zikes me 8.IO.1959. /: /

(Dosja Camaj)

Po kështu të duket e pamundur që Koliqi, i cili kishte rekomanduar për Shërbimin Sekret Gjerman eksponentë të diasporës kroate, rumune dhe bullgare të mos kishte afruar edhe Camajn për llogari të Shërbimeve Sekrete që ai kishte bashkëpunim. Për këtë, puna për nxjerrjen e “Shêjzat” i ofronte atij një mbulim të shkëlqyer. Ndërkohë nga një numër raportimesh që dërgonin agentët shqiptarë nga Italia, mund të kuptohet se Revista “Shêjzat” e cila në fillesat e saja kishte shumë pak lexues, tashmë dilte me një tirazh prej 3500 kopjesh, një pjesë e mirë prej të cilave dërgoheshin në Jugosllavi, dhe përveç financimeve amerikane merrte edhe financime Italiane.

GJERMANI

“Edhe Martin Camaj, për sa dimë, është kundër Shqipërisë. Prandaj s’kemi pse ia dërgojmë as “helmin”, lëre më shtypin tonë...” [Jusuf Gërvalla, Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982]¹.

Në vitin ‘61, Camaj vendoset në Mynih. Arsyeja e vërtetë e zhvendosjes së tij është e mjegullt. Megjithëse kishte vënë emër në qarqet albanologjike të Romës, ai lëviz drejt Milanos, ku lë Nina Bogdanovich Camaj dhe pak më vonë shkon në Mynih. Sigurisht një intelektual në kontekstin e kohës, kërkon të shikojë mundësitë më të mira për angazhimin e veprës së tij. Roma, për kohën ishte një ambient me një mërgatë të konsoliduar. Arbëreshët në Jug të Italisë mbanin gjallë ende gjuhën shqipe. Revista “Shëjzat” me financim amerikan dilte rregullisht me disa nga penat më të mira të kohës. Camaj ishte i angazhuar në Universitetin e Romës, ku punonte së bashku me Koliqin. Ministria e Jashtme Italiane i paguante një rrogë çdo muaj për shërbime shumë të paqarta. Përse vendosi të drejtohej në Gjermani, ku nuk kishte një mërgatë të fortë shqiptare, as ambiente kulturore dhe as qarqe të rëndësishme të albanologjisë?

Në kontekstin e kohës, vitet ‘60 ishin vite kur shërbimet sekrete kryesore e kishin humbur interesin e tyre për Shqipërinë. Operacionet klandestine ishin zhvendosur në vende të tjera. Financimet ishin rrudhur shumë e Shqipëria nuk ishte më fushëbeteja e përplasjeve të shërbimeve sekrete. Ndërkohë emigracioni kosovar në Gjermani po bëhej një faktor në rritje.

Mos vallë lëvizja e Camajt për Gjermani kishte të bënte me interesimin e UDB-së për organizatat kosovare? Apo bashkëpunimi i Ernest Koliqit me ish-Shefin e SD gjermane Karl Hass i kishte hapur rrugë edhe Camajt për të qenë në kontakt me këtë Shërbim? Mbi këtë pyetje i rikthehem përsëri informacionit që siguronte Zbulimi Politik Shqiptar për figurat e diasporës.

I N F O R M A T E:

Me 3 prill është kthyer në Gjermani Martin Camaj. Është parë të qarkulloje shumë rralle për tërë kohën që ka qëndruar në Rome, pse Ernest Koliqi e ka bllokuar duke e thirrur për ditë në shtëpi të tij. Në tërë ambientin e t’aratisurve janë të bindur se ai i bie lajme të shumta nga ana e Koliqit dhe se është personi me i besueshem i tij.

Burimi "210" dt.2/V/963 P.Op.(Xh.Hedo) dt.10/V/63

[Signature]

Pyetjet që lindin nga zhvendosja e Martin Camajt në Gjermani do të perpiqemi t’i analizojmë me disa dokumenta të deklasifikuara amerikane që vijnë nga një informator shqiptar i vendosur në Mynih.

¹ Ibrahim Kelmendi, “Gjurmë dhe fërkem”, f. 123, Prishtinë 2018.



(Koliqi, Camaj dhe Maloki)

Dokumenti më interesant, që sjell të dhëna të rëndësishme dhe dyshime mbi rolin e Camajt në Gjermani është një raport mbi figurën e Krist Malokit. Ky raport duket se është përgatitur nga një informator i cili operonte për llogari të zbulimit amerikan. Krist Maloki ishte një ekonomist dhe studiues me nënshtetësi austriake ardhur nga Prizreni. Në rininë e tij njihje mjaft mirë E. Çabejn dhe L. Poradecin. I njohur në rrethet letrare të Kosovës dhe me kontakte të mira në Shqipëri, ai është vendosur nën vëzhgimin amerikan, me shumë gjasë si pasojë e raportimit të informatorit nga Mynihu.

Dokumenti i 29 dhjetorit 1966, përgatitur nga Shefi i Stacionit të CIA-s në Vjenë, dërgon një raport për dy departamente, Deskun Sovjetik dhe atë të Europës Juglindore. Ky raport përmbante një “Vlerësim zbulimor” për Prof. Krist Malokin. Të dhënat janë marrë në Mynih në nëntor 1966, dukshëm nga një person që e njihje mirë Malokin.

DISPATCH	CLASSIFICATION	PROCESSING ACTION
SECRET		INDEXED FOR INDEXING
TO: Chief, SB		IS INDEXING REQUIRED
INFO: Chief, EUR		ONLY QUALIFIER NEW CAN BE INDEXED
FROM: Chief of Station, Vienna		DISPATCH
SUBJECT: UNAYOR [] [] Meeting with []		
ACTION REQUIRED - REFERENCES Action: See para. 1		
<p>1. On 19 and 20 November 1966 [] travelled to Munich and met with [] Although we have found nothing in the [] material of obvious dissemination value, we believe that some of the personality data in the attached contact report may deserve indexing for possible later operational use.</p> <p>2. Also attached is an assessment of Kristo MALOKI [] prepared by [] request. Although MALOKI does not appear himself to be an extremely promising target, he offers a means of access to Eren CABEJ, who is reportedly on good terms with both Enver HOXHA and Mehmet-SHEKHU and who, according to the [] contact report, is likely to travel to West Germany in early 1967.</p> <p>3. [] who has not yet obtained his West German citizenship, did not travel to Sofia for the congress on Balkan philology on 29 August - 2 September 1966. He did, however, obtain a complete list of the Albanian delegation to that congress, and a copy of it is attached. Please note that this list was rendered into English by [] who is also responsible for the parentheses.</p> <p>4. [] new book on Albanian linguistics has now been published, and he has already mailed six copies to the persons shown on the attached list. As suggested in EAVV-20076 of 17 August 1966, we paid [] for these copies of the book and will also pay for the purchase and mailing of a few additional gift copies.</p>		
Attachments: USC 1. Contact Report 2. Assessment of Kristo MALOKI 3. List of Albanian Delegation 4. List of persons getting [] new book		DECLASSIFIED AND RE CENTRAL INTELLIGENCE SOURCES METHODS SECT WAR CRIMES DIV DATE 2006 80 DEC 1966
Distribution: 2-Chief, SB w/att. 2-Chief, EUR w/att.		
GROUP REFERENCE TO	DISPATCH SYMBOL AND NUMBER EAVA 30417 CLASSIFICATION SECRET	DATE 30 December 1966

Po përse Krist Maloki është vënë në qender të interesimit amerikan?

2. Also attached is an assessment of Kristo MALOKI [redacted], prepared by [redacted] at [redacted] request. Although MALOKI does not appear himself to be an extremely promising target, he offers a means of access to Eqrem CABEJ, who is reportedly on good terms with both Enver HOXHA and Mehmet-SHEHU and who, according to the [redacted] contact report, is likely to travel to West Germany in early 1967.

“Maloki nuk duket një objektiv premtues, por ai ofron një mundësi aksesi tek Eqrem Çabej, i cili sipas raportimit është në marrëdhënie të mira me Enver Hoxhën dhe Mehmet Shehun dhe sipas (emri i fshirë) raportit të kontaktit, më shumë mundësi do të udhëtojë në Gjermaninë Perëndimore në fillim të 1967”.

Nga ky pasazh kuptohet qartë se Maloki ishte vënë në vëmendje të zbulimit amerikan si një objekt operacional për të mbledhur informacion nëpërmjet Eqrem Çabejt për dy liderët komunistë shqiptarë. Po kush mundet ta ketë njohur Krist Malokin kaq mirë sa të dinte këto marrëdhënie midis këtyre dy personave?

3. [redacted] who has not yet obtained his West German citizenship, did not travel to Sofia for the congress on Balkan philology on 29 August - 2 September 1966. He did, however, obtain a complete list of the Albanian delegation to that congress, and a copy of it is attached. Please note that this list was rendered into English by [redacted] who is also responsible for the parentheses.

Pasazhi i mësipërm na jep një profil të vagullt të burimit tonë;


“(emri i fshirë) nuk e ka marrë akoma nënshtetësinë gjermano-perëndimore, si dhe nuk ka udhëtuar dot në Sofje për Kongresin Filologjik Ballkanik në 29 gusht të 1966”.

Pra Informatori i Mynihut me gjasa nuk është gjerman dhe me sa duket duhet të jetë studiues/gjuhëtar i interesuar qartësisht për Kongresin Filologjik Ballkanik.

4. [redacted] new book on Albanian linguistics has now been published, and he has already mailed six copies to the persons shown on the attached list. As suggested in EAVW-20076 of 17 August 1966, we paid [redacted] for these copies of the book and will also pay for the purchase and mailing of a few additional gift copies.

4. Libri i (emri i fshirë) për linguistikën shqiptare tashmë është botuar...

Pra Informatori në Mynih ka botuar një libër në fushën e gjuhës shqipe më 1966, libër ky i blerë dhe arkivuar nga CIA. Me të drejtë lind pyetja: cili studiues ka botuar libër për linguistikën shqiptare në Gjermani më 1966? Nga një kërkim i thjeshtë del se “*Albanische Wortbildung*” është i vetmi libër që përmbush këtë kriter.



(emri i fshirë) kishte dëgjuar disa kohë më parë në Mynih nga Prof. Babinger se njerëzit në Tiranë nuk e pëlqenin gruan e Malokit sepse, sipas tyre, ajo ishte mëndjemadhe”, – vazhdon raporti...

Interesante është përmendja e orientalistit të famshëm gjerman, Franz Babinger, në këtë raport. Një studiues i shkëlqyer me një varg veprash të botuara, Babinger kishte ardhur dy herë në Shqipëri. Po cili ishte ai shqiptar me banim në Mynih që e njëjtte Prof. Babingerin? “*Historiaku zâmadh i Universitetit të Münebenit, Prof. Franz Babinger, me 28 mars 1960 mbajti n’Universitet të Romës një konferencë dituniplote mbi Konstantin Arianit Komnenin, pris shqiptar n’Itali*”, kjo ishte hyrja e një artikulli në “Shêjzat” për leksionin e Babingerit, shkruar nga Martin Camaj. Prof. Babinger ishte takuar në Romë që në 1960 me Martin Camajn, studiuesin dhe letrar shqiptar që do të vendosej me banim në Mynih.

Por e dhëna më interesante për identifikimin e informatorit që raportonte nga Mynih për shërbimin sekret amerikan është pasazhi i mëposhtëm:

[] made Malok's acquaintance in 1952 in Belgrade, Yugoslavia. At that time Malok visited his relatives in Prizren and in that occasion also in that occasion he met the new Kosovare intellectuals attending the university of Belgrade. Actually [] was in correspondence with Malok since 1951.

“(emri i fshirë) e ka njohur Malokin në 1952 në Beograd, Jugosllavi. Në atë kohë Maloki vizitoi farefisën e tij në Prizren dhe me atë rast takoi intelektualët kosovarë që ndiqnin Universitetin e Beogradit. Në fakt (emri i fshirë) ka qenë në korrespondencë me Malokin që në 1951.”

Për të shpjeguar këtë pasazh në ndihmë na vjen letra e Camajt për mikun e tij seminarist në Romë, ku konfirmon se e njeh mirë Prof. Malokin, aq sa t’i kërkojë edhe një garanci për ta nxjerrë atë jashtë Jugosllavisë.

Megjithëse dikur Camaj i kërkonte ndihmë profesorit shqiptar, në dokumentin e CIA-s, me nota të holla cinike, informatori i amerikanëve duket se e ironizon profesorin e moshuar, i cili në atë kohë vuante nga një sëmundje e rëndë e syve.

(emri i fshirë) “Maloki vlerësohet lart nga intelektualët e rinj kosovarë, dhe, në atë drejtim, dera mbetet gjithnjë e hapur; pra, me fjalë të tjera, Maloki do të kishte gjithnjë qasje të mirë me botën e kulturës në Jugosllavi, kurse mundësitë e afrimit të tij me Tiranën ishin praktikisht shumë të vakëta [very poor thing]” <https://peizazhe.com/2020/01/28/inteligjencia-shqiptare-ne-tehun-e-luftes-se-ftohte-ii/-ftn31>.

- “Maloki kishte shpresuar gjithnjë që të kthehej në Shqipëri, me gjasë për të zënë një pozitë të lartë kulturore atje”;

- “Tirana i kishte premtuar Malokit fitime të dyfishta të ndjeshme për përkthime dhe shërbime të tjera në fushën e propagandës”;

- “në Graz jeton i izoluar, dhe se dëshironte të kalonte pensionin në Shqipëri, ku kishte shokë shkolle, si Prof. Eqrem Çabej”;

Për ta përmbledhur analizën tonë mund të themi se hartuesi i këtij informacioni për një plan operacional në depërtimin e studiuesve shqiptarë për llogari të shërbimit amerikan në 1966 është i vendosur në Mynih. Nuk është ende shtetas gjerman. Ka studiuar në Universitetin e Beogradit në 1952, është i interesuar për linguistikën shqiptare, boton të vetmin libër linguistik për Shqipërinë në Gjermani në vitin 1966, njeh mirë Prof. Babingerin i cili udhëton në Shqipëri, ka raporte konfidenciale me Prof. Malokin dhe, megjithë sëmundjen e këtij të fundit, e propozon atë si një objekt me interes për të nxjerrë informacione nga Eqrem Çabej. Por në ndihmë të zgjidhjes së kësaj enigme na vjen një dokument i Zbulimit Politik Shqiptar, i cili nga një burim shumë i besuar me qendër në Angli, raportonte për Tiranën.

Nga një burim i pa sprovuar thuhet se disa zyrtarë të la-
 amerikanë i kishin thënë që Martini të shkonte në Bukuresht ose
 Budapest ku do të bëhej një mbledhje e disa profesorave dhe do
 kishte edhe profesora Shqipëtare. Të punonte me ta që këta të pun-
 me 15.000 studentat e Tiranës. Për këtë i kishin premtuar shpërb-
 të mira dhe se do ta vinin në krye të vendit kur "të çlirohej" Shq-
 rija. Martini e kishte pranuar këtë detyrë, por neve nuk kemi të d-
 në se ishte ky njeri ose jo në mbledhjen që u bë.

N/Kolonel
 (Male Zahaj)

A. Zahaj

Konc. dakt. M.Z.
 Ushtyp në një kopje.

Kjo e dhënë e zbulimit shqiptar, si dhe dokumenti amerikan përputhen në detaje për të na dhënë konkluzionin e nevojshëm se Martin Camaj ishte burimi në Mynih që kishte lidhje operative me shërbimin sekret amerikan, duke propozuar edhe emra konkretë të studiuesve të njohur shqiptarë për këto operacione. Në veçanti Eqrem Çabej, për të cilin Sigurimi i Shtetit fillon një survejim edhe më të rreptë, me dyshimin

se Çabej gjatë pjesëmarrjeve në konferenca ndërkombëtare, mund të vendoste kontakte me zbulimet e huaja.

Një dëshmi tjetër shumë interesante mbi marrëdhëniet Maloki-Camaj vjen nga një intervistë e zonjës austriake Maloki e veja e Krist Malokit, cila rrëfen”:

di çka ishte problemi, por Camaj dhe Koliqi disi janë larguar nga Kristi dhe para vdekjes më as kontakte të shpeshta nuk kishin. Sa kam mundur të kuptoj këtë punë Kristi ishte tepër i drejtpërdrejtë me ta, dhe ndoshta diçka nuk është pajtuar me ndonjë bisedë me ta. Por nuk duhet harruar se Kristi ka punuar jashtëzakonisht shumë që të krijohet katedra për gjuhë shqipe në München (Mynih) që e ka marrë Martini. Sa di unë këtë katedër ka mundur që edhe Kristi ta marrë, por ishin gjëra të tjera të jetës që nuk e lanë, sepse ai duhej të vendoste për martesën tonë apo për München. Kishte

(intervistë me Albert Rama)

Përse vallë Camaj-Koliqi kanë pasur kontradikta me Prof. Malokin? A ishin këto kontradikta mbi çështjen fonetikës së shqipes? Ekonomisë ku Maloki ishte ekspert i fushës? Gramatikës, drejtshkrimin apo diçka shumë më e thellë ka sjellë prishjen përfundimtare midis këtyre studiuesve? Mos vallë Koliqi, rekrutues informatorësh për zbulimet e huaja, ka tentuar të fusë në lojën e shërbimeve sekrete të huaja edhe Prof. Malokin? Mos vallë refuzimi i Malokit është edhe shkaku i mosmarrëveshjeve të cilat ndoshta i sollën edhe humbjen e Katedrës së gjuhës shqipe në universitetin e Mynihut, për të cilën flet e shoqja e tij?

Megjithëse në analizën tonë u morëm në veçanti me figurën e Krist Malokit, nuk ka dyshim se burimi i informacionit nga Munihu ka qenë mjaft aktiv për një kohë të gjatë, duke informuar edhe për emra të tjerë. Janë disa raportime ku puna e lavdërueshme e këtij burimi përmendet në raportimet e Zyrës së CIAs me qendër në Munih.

Në dokumentin e dates 12 maj 1966 në një raport të gjatë të CIA-s /Stacioni i Munihut për Zyrën e Europës Juglindore, ku analizohet mundësia e penetrimit të shërbimit sekret shqiptar ndaj emigracionit, të bie në sy edhe nje pasazh i shkurtër. Megjithëse me emrin e fshirë, mund të themi se Stacioni i Munihut i referohet burimit tonë. Kjo pasi dokumenti në fjalë është një përmbledhje e personalitetit të Malokit, por edhe të disa shqiptarëve të tjerë.

“Ne jemi të kënaqur me raportimet e (emri i fshirë) dhe shpresojmë që kohë pas kohe të na japë informacione për shqiptaret me të cilët ka kontakte sociale. Ne jemi akoma të interesuar për çfarëdo zhvillimi (emri i fshirë) në lidhje me përpjekjet për të rilidhur kontaktet në Shqipëri duke iu derguar libra miqve të tij”
((FOIA 519697ec993294098d50cbd0))

CIA duket se interesohet për të gjitha personalitetet e mundshme dhe burimi ynë i Munihut ka përgatitur një raport për disa prej tyre, ku përveç Krist Malokit, i cili për hir të së vërtetës ka qenë në listat e CIA-s që në fillimet e viteve 50 si njeri që vëzhgohej, burimi ynë informon edhe për një tjetër shqiptar, arkitektin Hajdar Kërçiku nga një familje e njohur tiranase, i cili kishte studiuar në Vjene dhe ishte vendosur në Graz pas një refuzimi të autoriteteve amerikane për emigracion në SH.B.A.

Kërçiku, i cili kishte familjen në Tiranë, kishte marrëdhënie shumë të mira me Ambasadën Shqiptare në Vjenë, dhe për këtë arsye ishte në listën e njerëzve të survejuar nga ana e amerikanëve.

Information on [redacted] in Attachment 3 was obtained in 1956 from [redacted] former YUGOSLAV contract agent whose information is considered reliable.

2. The Albania Embassy in Vienna has been attempting to expand its contacts and has been particularly interested in cultivating the Albanian intellectuals residing in Austria. Both MALOKI and ERMEKSI have been asked to participate in the newly established Austro-Albanian Society in Vienna and have been invited to numerous social functions at the Albania Embassy.

3. We have been pleased with [redacted] reporting and hope that he can, from time to time, provide information on Albanians with whom he has social contact. We are still interested in any developments regarding [redacted] efforts to renew contacts in Albania by sending books to his friends.

Ka shumë mundësi që ky aktivitet në favor të shërbimit amerikan dhe jo vetëm, ka ngjallur zemërimin e Zbulimit Shqiptar, i cili me anë të rrjetit të tij të bazuar edhe në diasporën kosovare në Gjermani propozon operacionin e demaskimit të Camajt përpara amerikanëve. Për këtë propozohet ose “botimi i dokumentit që kishte nënshkruar dikur si bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit, ose një “letër” që vinte nga kosovarët.

5.6.86

Zotni Martin Camaj ose me emrin Camovic

Këna ndi per ty e këna dashi me tpa per me ti thane do fjale. Masi amiten me t'gjetje (por këna me te gjetje) po ta qojne s'ke keti letor per me t'hanje se fort mira po e dije me shken t'ka shkolle e boll mirë po je shperblan. Ti e din fort mire s'ka meritjone amiqte e kombit e bashkëpunetoret e atyne qe po mytin ne gjak tane Kosoven martine. Je munde me mashtrje boll djelmoshia Kosovare t'ue u hjek si mik i tyne per me t'hapje kambe e fjalet e tyne ja ke qese UDBes shketare. Boll mire ta këna mende t'natin, por skena me te lene pa ta dhane shperblimin qe meriton. Ti po e nimon UDB me mush me tepor burgjet me shqiptare te meriton. "Profesora" e "shketare" si ti mik i lypen me Kosovare, as shqiptare, as kombit shqiptar, por atyne qe ikone t'ne e papajise. Kosova e Shqipëria këna boll shqiptare e shqiptare e shqiptare shqiptare ska mbet me prit prej nji bashkëpunetori te kombit e shqiptar te filiqu si ti. Prandaj vande mire gjatshin këna me t'at se te shketar.

Ermete Kosova
Ermete kombi shqiptar
Gjyter avat'konet
Vdekje spiunëve e tradhtarëve

Perqendrimi dhe detyrimi nga ana jone

P. U. V.
J. S. X. P.

(Dosja e Martin Camajt)

Megjithëse ky operacion nuk u finalizua, me interes është fakti se Zbulimi Sekret Shqiptar ishte i bindur se Camaj ishte informator i UDB-së.

Një tjetër e dhënë me mjaft interes është dëshmia e një personazhi të njohur Kosovar, si Jusuf Gervalla. A mos vallë Gervalla, i cili u vra në atentat nga Shërbimet Sekrete Jugosllave, dinte më shumë se ato që shkruan? Camaj në letrën e tij më 1957, ankohej që qarqet kosovare nuk e donin. Përse vallë? Mos ndoshta martesë me një shtetase serbe kishte prekur sentimentet e kosovarëve? Apo prania e Camajt ne Radio Beogradi dhe anëtarësimi në Komitetin e Prizrenit, një organizatë spiunazhi e UDB-së, e kishin bërë figurën e tij mjaft të dyshimtë? Për të gjitha këto pyetje ndoshta me hapjen e arkivave në Beograd do të mësojmë më shumë.

Për aktivitetin e Martin Camajn në fundin e viteve 80-të ka disa dëshmi mjaft interesante, të cilat në këtë analizë na bëjnë të ngremë disa hipoteza.

Fundi i këtyre viteve kishte pasur një zbutje të detyruar të autoriteteve komuniste shqiptare, të cilat shikonin me shqetësim ngjarjet në Europën Lindore. Disa studiues shqiptarë ishin lejuar për të studiuar në Universitetin e Mynihut, ku sigurisht emri i Martin Camajt ishte i njohur për ta. Nga dëshmia e disa prej këtyre studiuesve mësohet se gjatë takimeve që Camaj bënte me ta “**Bisedat e gjata dilnin jashtë kornizës së lingistikës apo interesimin e përgjithshëm ndaj Shqipërisë**”. Pyetjet për personalitetet e politikës dhe kulturës shqiptare të kohës si dhe mbështetjen e tyre politike për regjimin që po rrëzohej kanë vënë në dyshime bashkëbiseduesit e tij, të cilët edhe pas gati 30 vjetësh i kujtojnë ato si “**biseda shumë të çuditshme për një profesor të gjuhësisë**”. Këto biseda të asaj kohe të vendosura në kontekstin e kësaj analize na bëjnë të besojmë se Martin Camaj edhe në fundin e viteve 80 fillimin e viteve 90 vazhdonte aktivitetin e tij në dobi të zbulimeve të huaja që kishin interes për Shqipërinë.

MOS KOPJO

EPILOG

Martin Camaj. Vdiq në 12 Maj 1992. Pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri Martin Camaj nuk mundi të vizitonte përsëri vendlindjen. Dosja për vëzhgimin e tij vazhdoi deri në vitin 1992, ku mund të thuhet se materiali i pakët është tejet joprofesional duke nënkuptuar se Kundërzbulimi Sekret Shqiptar kishte humbur shumë nga shkëlqimi i dikurshëm. Veprat e Martin Camajt, dikur të ndaluara, tashmë janë botuar gjerësisht në Shqipëri; megjithëse sipas specialistëve të fushës, shkrimet e tij kanë vlerë letrare, por nuk janë letërsi antikomuniste.

Kapiten Fadil Kapizysi. Oficeri i Sigurimit të Shtetit që rekrutoi Martin Camajn, kaloi në detyra të ndryshme dhe më vonë u ngrit në detyrë deri në rangun e Zv. Kryetarit të Hetuesisë së Përgjithshme. I përfshirë në disa procese të rëndësishme të periudhës komuniste, më i rëndësishmi prej të cilëve ishte ai kundër klerik katolik në Shkodër.

Ernest Koliqi. Vdiq në Janar 1975 në Romë. I konsideruar si një personalitet i rëndësishëm i letrave shqipe u varros nga mërgata shqiptare e Romës. Figura e tij letrare është trajtuar veçanërisht nga intelektualët kosovarë dhe më pak në Shqipëri. Për ironi të historisë ndër medaljet që janë akorduar për të, është edhe Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit.

Krist Maloki. Vdiq në nëntor 1972 nga një sëmundje e pashërueshme. Vitet e fundit i kaloi në verbëri të plotë. Nuk mundi të vinte në Shqipëri siç kishte dëshiruar në fundin e karrierës së tij. Vepra e tij njihet shumë pak në Shqipëri dhe më shumë në Kosovë.

Dom Lazer Sheldija: Miku i Martin Camajt që nga koha e studimeve në Beograd. Vendoset në Romë në një seminar jezuit të propagandës FIDE. Konsiderohej njeri i afërm nga Camaj dhe ishte personi të cilit i'u drejtua për ndihmë me letrën e tij nga Beogradi. Nga Roma, Lazer Sheldija emigroi dhe jetoj për mbi 10 vjet në Argjentinë dhe Brazil, dhe më pas u vendos në Kaliforni dhe New York. Sipas gazetës New York Times (28 shtator '88), Prifti Sheldija ishte gjetur në banesë i torturuar dhe më pas ishte ekzekutuar me një plumb në kokë. Policia amerikane arrestoi për këtë vrasje dy shqiptarë, që i lëshoi për mungesë provash. Vdekja e tij ka mbetur mister.

I çuditshëm është një pohim i Martin Camajt për vrasjen e mikut të vet që nga kohët e emigracionit në Beograd *“jam i bindun se edhe në vrasjen e Dom Lazrit ka gisht SIGURIMI! Po qes një shembull fort sistematik”* (Martin Camaj letër për Gjon Sinishta München, 27 mars 1991 botuar nga B.Demiraj)

Në letrën në fjalë nuk ka asnjë shpjegim se përse Martin Camaj mendonte se Dom Lazri u vra nga Sigurimi i Shtetit. Të duket shumë e çuditshme që një prift katolik i larguar shumë herët, me aktivitet fetar në Amerikën Latine dhe me një aktivitet periferik në emigracionin e New Yorkut, të vritej nga Shërbimi Sekret Shqiptar. Aq më shumë në fundit e vitit 1988 ku Shërbimi inteligjent shqiptar nuk kishte as motiv dhe as mundësi për të bërë një atentat të tillë ndaj dikujt që nuk kishte aktivitet të dukshëm kundër regjimit. Mos vallë Martin Camaj dinte dicka më shumë për arsyet e vërteta të vrasjes së Pater Lazer Sheldisë?

Karl Hass, vdiq në Prill 2004 në një shtëpi të moshuarish në Romë. U dënua me burgim në 1998 nga një Gjykatë Ushtarake e Romës për rolin e tij në vrasjen e 355 robërve italianë në Shpellën Ardeatine. Dëshmitar i drejtësisë italiane në gjyqin e nazistit Erik Priebke në 1992, ndryshoi dëshminë duke refuzuar të dëshmonte kundër mikut të tij nazist.

Pader Daniel (Mark) Gjeczaj Vdiq në Gusht të 2002 në Romë. Mik i afërt me Ernest Koliqin ku bashkëpunoi për revistën “Shêjzat”. Kontribuoi në botimin e një sërë veprash të klerit katolik shqiptar. Redaktor përgjegjës ne Radio Vatikan për emisionet shqip. La pas disa dorëshkrime në shqip. Përfshirja e tij në Komitetin e Prizrenit nuk është shpjeguar asnjë herë nga biografët e tij.

MOS KOPJO